



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosova**  
**Qeveria e Kosovës - Vlada Kosova - Government of Kosova**  
*MINISTRIA E ARSIMIT SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË*  
*MINISTARSTVO ZA OBRAZOVANJE NAUKU I TEHNOLOGIJU*  
*MINISTRY OF EDUCATION SCIENCE & TECHNOLOG*

# UDHËZUESI PRAKTIK PËR ZBATIMIN E DOKUMENTIT TË STANDARDEVE TË ZHVILLIMIT DHE TË MËSUARIT NË FËMIJËRINË E HERSHME 0 - 6 VJEÇ



**Prishtinë, 2015**



**REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVA**  
**QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA /GOVERNMENT OF KOSOVA**  
**MINISTRIA E ARSIMIT SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË**  
**MINISTARSTVO ZA OBRAZOVANJE NAUKU I TEHNOLOGIJU**  
**MINISTRY OF EDUCATION SCIENCE & TECHNOLOG**

***UDHËZUESI PRAKTIK PËR ZBATIMIN E DOKUMENTIT  
TË STANDARDEVE TË ZHVILLIMIT DHE TË MËSUARIT  
NË FËMIJËRINË E HERSHME 0 - 6 VJEÇ***

**Prishtinë, 2015**

*Botues*

**Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë**

*Redaktorë përgjegjës*

**Labëri Luzha**

**Rand Engel**

*Autorët e Udhëzuesit*

**1. Merita Shala**

**2. Alida Thaqi**

**3. Mimoza Shahini**

**4. Adhurim Rasimi**

*Përgatitja teknike*

**Projectgraphics**

*Lektura*

**Sabit Jaha**

---

Ribotimi autorizohet vetëm nga MASHT

Publikimi gjendet ne formatin elektronik në ueb-faqen e MASHT: <http://masht.rks-gov.net>

Përmbajtja e Udhëzuesit

<b>Hyrja</b> .....	5
<b>FUSHA E ZHVILLIMIT: SHËNDETI FIZIK DHE ZHVILLIMI LËVIZOR</b> .....	8
TEMA <b>ZBULOJMË FORMAT DHE MADHËSITË</b> .....	8
TEMA <b>MUAJI I FESTAVE</b> .....	9
TEMA MUJORE <b>NDRYSHIMET KLIMATIKE</b> .....	11
TEMA JAVORE <b>NË BOTËN E PËRRALLAVE</b> .....	12
TEMA <b>NDËRTOJMË ME DUART TONA</b> .....	13
TEMA MUJORE <b>TË GJITHË TË NDRYSHËM, TË GJITHË TË BARABARTË</b> .....	14
<b>FUSHA E ZHVILLIMIT TË: GJUHA DHE KOMUNIKIMI</b> .....	16
TEMA <b>BOTA E GJALLË</b> .....	16
TEMA <b>SHOQËRIA</b> .....	17
TEMA <b>PRANVERA</b> .....	19
TEMA <b>KOPSHTI IM</b> .....	20
TEMA <b>PËRRALLAT</b> .....	21
TEMA <b>TRUPI</b> .....	23
TEMA <b>MIQËSIA</b> .....	25
TEMA <b>PËRKUJDESJA PËR TË TJERËT</b> .....	26
TEMA <b>RESPEKTI</b> .....	27
TEMA <b>EMOCIONET</b> .....	28
TEMA <b>ZGJIDHJA E PROBLEMEVE</b> .....	29
<b>FUSHA: ZHVILLIMI NJOHËS DHE NJOHURITË E PËRGJITHSHME</b> .....	30
TEMA <b>KAFSHËT</b> .....	30
<b>FUSHA: ZHVILLIMI NJOHËS DHE NJOHURITË E PËRGJITHSHME</b> .....	31
TEMA <b>OBJEKTI PERMANENT</b> .....	31
TEMA <b>KAFSHËT</b> .....	32
TEMA <b>AMBIENTI</b> .....	33
TEMA <b>HIGJIENA PERSONALE</b> .....	34
TEMA <b>NJERIU DHE NATYRA</b> .....	35
<b>FUSHA: ZHVILLIMI MATEMATIKOR</b> .....	36
TEMA <b>KOMUNIKACIONI</b> .....	36
TEMA <b>KOMUNIKACIONI</b> .....	37
TEMA <b>KOMUNIKACIONI</b> .....	38
TEMA <b>FESTAT</b> .....	40
TEMA <b>USHQIMI</b> .....	41
TEMA <b>NJERËZIT</b> .....	42

FUSHA: <b>ARTI DHE MUZIKA</b> .....	44
TEMA <b>MUZIKOJMË SË BASHKU</b> .....	44
TEMA <b>KOMUNIKACIONI</b> .....	45
TEMA <b>KËNGËT FESTIVE</b> .....	47
TEMA <b>UNË PO RRITEM - (trupi im)</b> .....	48
TEMA <b>STINËT</b> .....	49
TEMA <b>KAFSHËT</b> .....	50
FUSHA: <b>QASJA NDAJ TË MËSUARIT</b> .....	52
TEMA <b>NDËRTOJMË ME DUART TONA</b> .....	52
TEMA <b>UNË MUNDEM VETË</b> .....	53
TEMA <b>NDRYSHIMET KLIMATIKE</b> .....	54
TEMË <b>JAVORE NË BOTËN E PËRRALLAVE</b> .....	55
TEMA <b>NDËRTOJMË ME DUART TONA</b> .....	56
TEMË <b>MUJORE TË GJITHË TË NDRYSHËM, TË GJITHË TË BARABARTË</b> .....	57
Literatura .....	59

## **Pjesa e parë**

### **Hyrja**

Udhëzuesi praktik për zbatimin e dokumentit të Standardeve të Zhvillimit dhe të Mësuarit në Fëmijërinë e Hershme 0-6 vjeç, është një udhëzues i cili u ofrohet edukatoreve si mbështetje në përfundimin e njohurive të cilat tashmë i kanë përfituar gjatë trajnimit 7 ditor.

Ky Udhëzues është vazhdimësi e dokumenteve të cilat në mënyrë hierarkike e ndihmojnë dhe e bëjnë të zbatueshëm njëri-tjetrin. Udhëzuesi ofron informata për jetësimin e vlerave dhe parimeve mbi të cilat është mbështetur dokumenti i SZHMFH-së, si individualiteti, autonomia, vetëbesimi koncepti pozitiv për veten, zhvillimi i tërësishëm i fëmijëve, zhvillimi i aftësive komunikuese, kreativiteti, respekti dhe dashuria ndaj vendit, përgjegjësia sociale.

Ndërsa parimet mbi të cilat mbështetet realizimi i përmbajtjes së dokumentit të standardeve është: barazia, zhvillimi i gjithanshëm i fëmijës, bashkëpunimi në mes të faktorëve edukativë, loja dhe të mësuarit duke ndërvepruar, çdo fëmijë është i gatshëm të mësojë nga lindja dhe fëmija pjesëmarrës aktiv.

### **Përmbajtja e Udhëzuesit**

Udhëzuesi përmban pjesën e parë në të cilën sqarohen konceptet bazë, rëndësia e tij, qëllimi dhe mënyra e përdorimit. Pjesa e dytë, përmban udhëzime praktike si duhet vepruar në cilëndo fazë të planifikimit dhe organizimit të aktiviteteve me fëmijët, duke u mbështetur në standardet e zhvillimit dhe kurrikulën parashkollore.

Pjesa e tretë përmban modele të aktiviteteve të planifikuara dhe të realizuara me fëmijët e të gjitha grupmoshave për të gjitha fushat e zhvillimit, të përfshira në dokumentin e standardeve të zhvillimit dhe të mësuarit të fëmijëve. Temat e përdorura janë marrë nga planet mujore, javore të disa institucioneve parashkollore në Prishtinë.

### **Rëndësia e Udhëzuesit**

Ky Udhëzues me shembuj praktikë të planifikimit të aktiviteteve ditore është hartuar për mbështetjen e edukatoreve në zbatimin e dokumentit të SZHMFH-së. Shembujt e planifikimeve, hierarkisë së planifikimit, lehtësojnë të kuptuarit e edukatoreve dhe i ndihmojnë ato gjatë planifikimit të punës ditore mbështetur, në standardet e zhvillimit dhe në kurrikulën e edukimit parashkollor.

## **Qëllimi i udhëzuesit**

Meqë edukatorët që punojnë me të gjitha grupmoshat e fëmijëve në edukimin parashkollor, parafillor janë akteret kryesore në zbatimin e dokumenteve profesionale. Ky udhëzues ka për qëllim ngritjen profesionale për të kuptuar dhe për të jetësuar në praktikat e përditshme të punës me fëmijët dokumentin e Standardeve të zhvillimit në planifikimin ditor duke përcaktuar temën, përzgjedhjen e fushës, përzgjedhjen e standardit, përcaktimin e treguesit, përcaktimin e pritshmërisë për arritjen e fëmijëve, përshkrimin e organizimit të aktivitetit, si dhe reflektimin.

Përdorimi i Udhëzuesit

Udhëzuesi do të përdoret si material shtesë pas trajnimit të edukatoreve për fushat e caktuara zhvillimore të fëmijëve, për të zhvilluar më tej aftësitë e edukatoreve në planifikim të organizuar mirë. Ky udhëzues përmban modele praktike ditore të planifikimit për shtatë fushat e dokumentit të Standardeve.

## **Pjesa e dytë**

Udhëzuesi për përdorimin e dokumentit të Standardeve të Zhvillimit dhe të Mësuarit në Fëmijërinë e Hershme 0-6 vjeç, në zgjedhjen e aktiviteteve ditore.

Duke qenë se dokumenti i Standardeve nuk ka për qëllim të zëvendësojë apo mbivendoset mbi dokumentet e tjera, të përpiluara për punën tuaj të përditshme, përmbajtja e tij duhet të shihet si një mundësi për të pasuruar dhe lehtësuar punën tuaj të përditshme me fëmijët.

## **Mbani mend!**

1. Aktiviteti duhet të jetë i arritshëm nga shumica e fëmijëve me pak ndihmë (60% e fëmijëve duhet ta arrijnë këtë aktivitet)
2. Duhet të jetë i përshtatshëm për moshën e fëmijëve
3. Duhet të jetë i orientuar në qëllim

## **Përzgjedhja e fushës:**

Mbështetur në planin mujor ose javor, përcaktoni njëri prej fushave të zhvillimit, e cila do të jetë në fokus të aktivitetit ditor.

## **Përzgjedhja e Standardit:**

Kini kujdes që t'iu referoheni të gjitha standardeve gjatë planifikimit dhe organizimit të aktivitetit tuaj. Kjo siguron zhvillimin e përgjithshëm të fëmijës.

## **Përzgjedhja e treguesit:**

Referojuni grupmoshës së fëmijëve me të cilët punoni. Kur treguesi është i vështirë, shfrytëzo treguesin e grupmoshës më të vogël, kur treguesi është i lehtë, shfrytëzo treguesin e grupmoshës më të madhe.

## **Formulimi i rezultatit të pritur:**

Rezultati i pritur është veprimi, sjellja që presim që fëmijët të bëjnë si rezultat i angazhimit të tyre në aktivitet. Rezultati shkruhet përmes një folje konkrete, vepruese, të vëzhgueshme, të matshme dhe reale. Në rastet kur keni fëmijë me nevoja të veçanta arsimore në grup, rezultati i pritur për ta vendoset mbështetur mbi zhvillimin e tyre dhe çka pritet që ata të realizojnë gjatë aktivitetit.

## **Organizimi i aktivitetit:**

Duhet të siguroheni që të gjithë fëmijëve t'ju jepet mundësia që të praktikojnë disa herë veprimin, sjelljen që duam ta realizojnë në fund të aktivitetit. Aktiviteti duhet të ketë fëmijën në qendër dhe të jetë lojë, argëtim. Të gjithë fëmijët duhet të jenë pjesë e aktivitetit, lojës, argëtimit. Edukatorët mund të përcaktojnë pritshmëri të ndryshme të fëmijët në varësi të veçorive të tyre zhvillimore. Ky model planifikimi ditor, i mbështetur në dokumentin e SZHMFH-së, nuk e përjashton edhe pjesën tjetër të ditës që e realizoni me fëmijët siç është rutina ditore dhe aktivitetet pas gjumit, të cilat e përforcojnë zhvillimin dhe të mësuarit e fëmijëve. Mirëpo ne në fokus të ditës do ta kemi këtë planifikim ditor.

## **Reflektimi**

Kryhet pas çdo aktiviteti. Shkruajmë sa u realizua rezultati i pritur, me cilat fusha ishte i lidhur dhe a keni siguruar gjithëpërfshirjen e fëmijëve në këtë aktivitet.

Para çdo planifikimi, shikojmë reflektimin e aktivitetit të kaluar në mënyrë që të dimë me saktësi çfarë do të planifikojmë dhe si. Kjo na siguron edhe lidhmërinë ndërmjet fushave dhe zhvillimin tërësor të fëmijëve.



## Fusha e zhvillimit: **Shëndeti fizik dhe zhvillimi lëvizor**

I REFEROHEMI  
SZHMFH

**MODEL PLANIFIKIMI**

Marrë nga planifikimi  
vjetor, mujor, javor i  
institucionit

<p><b>6 - 18 MUAJ</b></p>	<p>TEMA <b>ZBULOJMË FORMAT DHE MADHËSITË</b></p>
<p><b>NËNFUSHA</b></p>	<p><b>Zhvillimi i aftësive senso-lëvizore</b></p>
<p>STANDARDI</p>	<p>Fëmijët përdorin shqisat për të rregulluar lëvizjet e tyre</p>
<p>TREGUESI</p>	<p>Ecën drej një objekti me ngjyrë apo formë të caktuar</p>
<p>PLANIFIKIMI I AKTIVITETIT TË TË MËSUARIT</p> <p>Zgjidhni atë lojë, aktivitet që ju mundëson fëmijëve të zhvillojnë të paktën 6-8 herë veprimin e prituri!</p>	<p><b>Nëntema:</b> Gjejmë së bashku formën e kërkuar</p> <p><b>Rezultati i prituri:</b> Fëmijët mbledhin lodrat me të njëjtën formë.</p> <p>Shkruhet në formën e foljes vepruese, konkrete, të matshme, të vëzhgueshme</p> <p><b>Materialet dhe mjetet:</b> 3 shporta me lodra që kanë tre forma të njëjta [p.sh. kukulla, topa, kutiza/kuba] me numër më të madh se numri i fëmijëve, salla e edukimit fizik, CD me muzikë.</p> <p><b>Organizimi i aktivitetit:</b> Vendosim pak muzikë në sfond dhe mbledhim fëmijët rreth e qark vetes duke i stimuluar që edhe ata të lëvizin me muzikën. I udhëzojmë në disa prej lëvizjeve, por edhe ju japim hapësirë që të krijojnë vetë lëvizjet e tyre. Më pas ju tregojmë për lojën që do të zhvillojmë dhe ju japim udhëzime të qarta.</p> <p>Vendosim në qendër të sallës tri shporta: I ndajmë fëmijët në tre grupe dhe nga një fëmijë i secilit grup kërkojmë që të zgjedhë cila formë e lodrave i pëlqen më shumë. Të gjithë fëmijët e shohin dhe e prekin lodrën e grupit të tyre. Ndërkohë ne kemi shpërndarë nëpër sallë të gjitha lodrat dhe kërkojmë nga fëmijët e secilit grup t'i gjejnë vetëm lodrat</p>

	e grupit të tyre dhe t'i hedhin ato në shportën e tyre. Ju tregojmë fëmijëve që loja përfundon kur edukatorja përplas fort duart. Kujdesemi që secili fëmijë të kërkojë dhe të gjejë lodrat e grupit të tij. Ofrojmë ndihmë kur shohim që fëmija është afër lodrës...lavdërojmë dhe stimulojmë gjithëpërfshirjen.
REFLEKTIMI	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Të gjithë fëmijët kërkuar nëpër sallë dhe shumica e tyre arritën të gjejnë lodrat e grupit të tyre.</li> <li>- Aktiviteti u lidh me shprehjen e aktivitetit, standardi 2- fëmija shfaq interesim për muzikën dhe aktivitete të ndryshme muzikore; dhe me zhvillimin e shkencës standardi 1-fëmija mbledh informata për ambientin përmes vëzhgimit dhe manipulon me këtë; me zhvillimin emocional, standardi 3- fëmija manifeston aftësi të rregullimit të emocioneve</li> <li>- U sigurua gjithëpërfshirja e fëmijëve në aktivitet.</li> </ul>

***Jepuni përgjigje këtyre pyetjeve:***

1. Sa fëmijë e realizuan rezultatin e pritur?
2. Me cilat fusha u integrua aktiviteti?
3. Sa u sigurua gjithëpërfshirja e fëmijëve?

18 - 24 MUAJ

TEMA  
**MUAJI I FESTAVE**

**NËNFUSHA**

**Shëndeti fizik dhe kujdesi për veten**

STANDARDI

Fëmijët tregojnë shkathtësi në plotësimin e rutinës ditore gjatë veshjes dhe ushqyerjes

TREGUESI

Vishet me pak ndihmë nga të rriturit

PLANIFIKIMI I  
AKTIVITETIT TË TË  
MËSUARIT

**Nëntema:** Dalim shëtitje

**Rezultati i pritur:** Vesh xhupin/jaknen me pak ndihmë

**Materialet dhe mjetet:** Veshjet e fëmijëve, ambienti i jashtëm i kopshtit

**Organizimi i aktivitetit:**

Një ditë më parë kërkojmë nga prindërit që në varësi të kohës, të veshin fëmijët pak më trashë ose t'u japin fëmijëve me vete një çadër ose një qese plastmase të mbeturinave në masën e fëmijës. Ne sigurohemi që qeseve plastmase u hapim me gërshërë vendet e krahëve dhe kokës për secilin fëmijë. E fillojmë aktivitetin duke biseduar me fëmijët rreth shëtitjeve që ata bëjnë me familjet e tyre, ku shkojnë zakonisht, sa shpesh dalin, a dalin edhe kur ka shi apo borë? Cilat vende vizitojnë zakonisht etj. Kujdesemi që secili fëmijë të japë një përgjigje në cilëndo prej pyetjeve.


Më pas ju tregojmë që edhe ne sot do të bëjmë një shëtitje nëpër oborrin e kopshtit tonë. Por që të dalim shëtitje sa më shpejt secili duhet të veshë vetë xhupin, pallton e tij/saj. Sjellim veshjet e fëmijëve në sallë dhe secili fëmijë gjen veshjen e tij/saj dhe provon ta veshë vetë. Vëzhgojmë me kujdes dhe ofrojmë ndihmë vetëm për ata fëmijë që edhe pse përpiqen nuk mundin të veshin xhupin; udhëzojmë qartë duke e demonstruar me veshjen tonë se si duhet të vishet xhupi/palltoja. Kur të kenë veshur të gjithë xhupin/palltot dalim në korridor dhe me ndihmën e kolegeve sigurojmë që të gjithë fëmijët kanë mbathur këpucët e tyre. Tash jemi gati për të shëtitur... udhëhiqni ata drejt një drejtimi të caktuar por edhe lejojini fëmijët të eksplorojnë ambientin e kopshtit...mund të bisedoni me ta për kohën dhe arsyen e veshjes së xhupit...shëtitja zgjat aq sa përcakton edukatorja.

*Mos jepni  
udhëzime  
të gjata!  
Jini sa më  
konkretë  
dhe të  
qartë!*


REFLEKTIMI



Shumica e fëmijëve e veshën pallton me pak ndihmë  
y- nuk arriti ta veshë pallton


Aktiviteti u ndërlidh me të dëgjuarit dhe të folurit, standardi 2 –fëmija tregon aftësi për të dëgjuar dhe kuptuar gjuhën e folur, me standardin 4 – fëmija shpreh aftësi kreative gjuhësore; me zhvillimin emocional-standardi 1 –fëmija demonstroi se njeh konceptin për veten; me qasjen ndaj të mësuarit, standardi 1 – fëmija shpreh interes dhe kuriozitet për të mësuar gjëra të reja.

 <p>2-3 VJEÇ</p>	<p>TEMA MUJORE <b>NDRYSHIMET KLIMATIKE</b></p>
<p><b>NËNFUSHA</b></p>	<p><b>Zhvillimi i aftësive lëvizore bazike [muskujt e mëdhenj]</b></p>
<p>STANDARDI</p>	<p>Fëmijët tregojnë aftësi të zhvillimit të ekuilibrit [baraspesha]</p>
<p>TREGUESI</p>	<p>Fëmija ndjek një vijë të vizatuar në dysHEME</p>
<div data-bbox="193 474 465 840" style="border: 2px solid blue; border-radius: 50%; padding: 10px; text-align: center;"> <p><b>Mund të jenë rreth 15-20 nëntema për çdo temë mujore për të gjitha fushat</b></p> </div> <p>PLANIFIKIMI I AKTIVITETIT TË TË MËSUARIT</p>	<p><b>Nëntema:</b> Shkojmë për skijim/ të rrëshqasim në borë</p> <p><b>Rezultati i pritur:</b> Ecin, rrëshqasin në shtegun/rrugën e vizatuar</p> <p><b>Materialet dhe mjetet:</b> tri rrugë/shtigje të vizatuara në dysHEME me trashësi mbi 4-5 cm me leqe, kodrina e gropa</p> <p><b>Organizimi i aktivitetit:</b>  <i>Opsioni 1:</i> nëse ka borë, nxjerrim fëmijët në oborr. Në këtë rast kërkojmë nga prindërit që të veshin fëmijët pak më trashë dhe të sigurojnë brenda mundësive nga një rrëshqitëse plastike për secilin fëmijë.  <i>Opsioni 2:</i> Vendosim një këngë me dimrin/borën në sfond dhe duke lëvizur edhe ne thërrasim fëmijët të mbliohen në rreth e të bëjnë lëvizje sipas muzikës e të na tregojnë për çfarë bën fjalë kënga.  <i>Opsioni 3:</i> vendosim një CD në të cilën tregohen male me borë, e njerëz që skijojnë dhe i angazhojmë fëmijët të na tregojnë çfarë po shohin.  Pyesim a kanë rrëshqitur ndonjëherë mbi borë? A ju ka pëlqyer? Si e kanë mbajtur trupin? A janë rrëzuar? Më pas ju tregojmë që do të ecim dhe rrëshqasim në rrugën që kemi vizatuar. I ndajmë në tre grupe dhe demonstrojmë veprimin. Pastaj i lejojmë që të provojnë të ecin e rrëshqasin në të tre shtigjet. Kujdesemi që secili fëmijë të provojë disa herë. Loja përfundon në kohën e përcaktuar.</p>
<p>REFLEKTIMI</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Pjesa më e madhe e fëmijëve ecnin nëpër shtigje/rrugë</li> <li>- Vetëm tre prej tyre kanë rrëshqitur</li> <li>- Aktiviteti u ndërlihd me zhvillimin gjuhësor, standardi 2 – fëmija tregon aftësi për të dëgjuar dhe kuptuar gjuhën e folur; me zhvillimin emocional-standardi 2-fëmija përjeton, njeh dhe shpreh emocionet; me shkencën, standardi 3 –fëmija vëzhgon dhe përshkruan karakteristikat e botës jo të gjallë, me qasjen ndaj të mësuarit, standardi 1-fëmija shpreh interes dhe kuriozitet për të mësuar gjërat e reja.</li> <li>- Djemtë u treguan më të shkathët sesa vajzat.</li> </ul>

*Reflektimi shkruhet vetëm pasi e kemi përfunduar aktivitetin me fëmijët!  
Gjeni një kohë brenda rutinës ditore për të reflektuar për aktivitetin .....asnjëherë mos e lini reflektimin për ditën tjetër!*

 <p>3 - 4 VJEÇ</p>	<p>TEMA JAVORE <b>NË BOTËN E PËRRALLAVE</b></p>
<p><b>NËNFUSHA</b></p>	<p><b>Zhvillimi i aftësive lëvizore fine</b></p>
<p>STANDARDI</p>	<p>Fëmijët tregojnë aftësi të koordinimit sy-dorë</p>
<p>TREGUESI</p>	<p>Krijon figura të ndryshme të përbëra [me format e dhëna]</p>
<div data-bbox="193 491 461 1046" style="border: 1px solid black; padding: 10px; margin-bottom: 10px;"> <p style="text-align: center;">↑</p> <p style="text-align: center;"><i>Përmërritjen e një treguesi, ju mund të zhvilloni 8-10 aktivitetet. Kini parasysh që treguesit janë të lidhur me njëri-tjetrin. Përcaktimi i aktiviteteve varet nga nevojat, kërkesat dhe interesat e fëmijëve.</i></p> </div> <p>PLANIFIKIMI I AKTIVITETIT TË TË MËSUARIT</p>	<p><b>Nëntema:</b> Gjejmë personazhin e përrallës</p> <p><b>Rezultati i pritur:</b> Bashkuan pjesëzat për të krijuar figurën e plotë</p> <p><b>Materialet dhe mjetet:</b> Fletë A4/postera të vegjël me figura, pamje të ngjyrosura, të prera në disa pjesë, për secilin fëmijë. Një poster me 3-4 pjesëza/copëza lëvizëse si pjesë e një figure të plotë.</p> <p><b>Organizimi i aktivitetit:</b> Një ditë më parë, edukatorja përgatit nga një fletë për secilin fëmijë në të cilën është e vizatuar një formë apo pamje. Edukatorja e pret fletën në disa pjesë. Para se të fillojë aktiviteti edukatorja vendos në tavolinë fletët e prera për secilin fëmijë. Aktiviteti fillon duke kërkuar nga fëmijët që të shohin duart e tyre dhe të na tregojnë sesa veprime mund të bëjnë me to....edukatorja ndjek idenë e fëmijëve duke e realizuar me duart e saj....njëkohësisht ofron edhe ide të tjera [i lidhim gishtat bashkë, i mbledhim, mund të bëjmë figura si zemra, rrethi etj.]. Kujdesemi që të gjithë fëmijët të bëjnë lëvizjet me duart e tyre. Më pas kërkojmë që fëmijët të shohin posterin dhe të na tregojnë si mund t'i lëvizim pjesëzat për të fituar figurën/personazhin e duhur. Edukatorja dëgjon fëmijët dhe bën veprimin duke plotësuar figurën. Më pas u tregojmë fëmijëve që secili prej tyre në tavolinë ka nga një poster të tillë të vogël/fletë A4, të cilin duhet ta krijojnë duke bërë bashkë pjesëzat e veçanta. Fëmijët ulen sipas dëshirës dhe punojnë individualisht. Stimulojmë fëmijët që edhe t'i gjejnë emrin e personazhit. Udhëzojmë fëmijët që kur kanë nevojë për ndihmë t'ju drejtohen ju ose shokut/shoqes më afër. Sigurojmë që të gjithë fëmijët angazhohen dhe ofrojmë udhëzime dhe ndihmë aty ku e shohim të arsyeshme. Posterët/fletët e plotësuar me personazhet ngjiten në mur nga fëmijët.</p>
<p>REFLEKTIMI</p>	<p>Të gjithë fëmijët e plotësuan figurën. Aktiviteti u ndërlidh me fushën e gjuhës, standardi 2 - fëmija tregon aftësinë për të dëgjuar dhe kuptuar gjuhën e folur; me qasjen ndaj të mësuarit, standardi 3 - fëmija këmbëngul edhe kur përballet me vështirësi, me zhvillimin emocional, standardi 2 - fëmija përjeton, njeh dhe shpreh emocionet.</p>

 <p>4-5 VJEÇ</p>	<p>TEMA <b>NDËRTOJMË ME DUART TONA</b></p>
<p><b>NËNFUSHA</b></p>	<p><b>Zhvillimi i aftësive lëvizore fine [muskujt e vegjël]</b></p>
<p>STANDARDI</p>	<p>Fëmijët tregojnë aftësi të përdorimit të duarve dhe gishtave</p>
<p>TREGUESI</p>	<p>Mbërthen apo zbërthen kopsat, pullat apo zinxhirin e veshjeve [palltos, xhupit] të tij/saj</p>
<p>PLANIFIKIMI I AKTIVITETIT TË TË MËSUARIT</p>	<p><b>Nëntema:</b> Figurat prej brumi, plasteline, balte, pambuku etj</p> <p><b>Rezultati i pritur:</b> Krijojnë figura sipas dëshirës</p> <p><b>Materialet dhe mjetet:</b> topa të vegjël brumi për secilin fëmijë dhe makarona të llojeve të ndryshme.</p> <p><b>Organizimi i aktivitetit:</b> Të ulur në rreth, pyesim fëmijët për llojet e ushqimeve prej brumi që ju pëlqejnë më shumë.</p> <p>Ju tregojmë materialet që kemi përgatitur për ta dhe kërkojmë të na tregojnë se çfarë mund dhe duan që të bëjnë me këto materiale.</p> <p>Pasi jemi siguruar që secili fëmijë ka thënë një mundësi/dëshirë i drejtojmë për në tavolina dhe i stimulojmë që të punojnë me brumin dhe makaronat. I mbikëqyrim në vazhdimësi duke u siguruar që secili të angazhohet në krijimin e së paku 1-2 figurave.</p> <p>Punët e vendosura në secilën tavolinë, i shikojnë të gjithë fëmijët e grupit.</p> <div data-bbox="1075 556 1354 765" data-label="Image">  </div> <div data-bbox="198 677 462 901" data-label="Text"> <p><i>Sigurori që të gjithë fëmijët të përfshihen në çdo fazë të aktivitetit</i></p> </div> <div data-bbox="556 994 1203 1191" data-label="Text"> <p><i>Lavdëroni fëmijët për anqazhimin e tyre! 😊</i></p> </div>
<p>REFLEKTIMI</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Të gjithë fëmijët krijuan figura të ndryshme</li> <li>- Fëmija X – nuk krijoi asnjë figurë me kuptim</li> <li>- Aktiviteti u ndërlidh me zhvillimin emocional, standardi 1 – fëmija demonstroi se njeh konceptin për veten; me zhvillimin njohës, shprehjen e kreativitetit, standardi 3- fëmija tregon interes për të marrë pjesë në aktivitete vizuale; qasjen ndaj të mësuarit, standardi 4- fëmija përdori imagjinatën dhe kreativitetin.</li> <li>- Të gjithë fëmijët morën pjesë në aktivitet.</li> </ul>

<div style="border: 2px solid red; padding: 5px; text-align: center;"> <b>5-6 VJEÇ</b> </div>	<b>TEMË MUJORE</b> <b>TË GJITHË TË NDRYSHËM, TË GJITHË TË BARABARTË</b>
<b>NËNFUSHA</b>	<b>Zhvillimi i aftësive lëvizore bazike [muskujt e mëdhenj]</b>
<b>STANDARDI</b>	Fëmijët tregojnë aftësi të koordinimit të lëvizjeve të tyre
<b>TREGUESI</b>	Fëmija kërcen me lehtësi në sipërfaqe të vizatuara
<div style="text-align: center;">  <p style="writing-mode: vertical-rl; transform: rotate(180deg);">Aktivitetet duhet të vështrësohen sa herë që përsëriten. Shtoni elementë që e bëjnë lojën më sfiduese dhe argëtuese për fëmijët</p> </div> <p><b>PLANIFIKIMI I AKTIVITETEVE TË TË MËSUARIT</b></p>	<p><b>Nëntema:</b> Kërcejmë nëpër forma</p> <p><b>Rezultati i pritur:</b> Fëmijët kërcëjnë me të dy këmbët në format e përcaktuara</p> <p><b>Materialet dhe mjetet:</b> Forma të vizatuara në oborr ose në dysheme dhe shporta me topa ose lodra në njërin skaj dhe shportë bosh në skajin tjetër</p> <p><b>Organizimi i aktivitetit:</b>  Bashkë me fëmijët zhvillojmë një lojë argëtuese të shoqëruar me muzikë, sa për të nxehur muskujt e tyre. Më pas i udhëzojmë që të vendosin në tre shirita, format në dysheme, ose edhe në oborr dhe në krye të tyre vendosim qesen e prerë. I ndajmë fëmijët në tre grupe sipas shortit dhe i udhëzojmë që duhet të kërcëjnë me të dy këmbët nëpër forma dhe të marrin një top/lodër nga shporta. Sërisht në rrugën kthyesë duhet të kërcëjnë brenda formave dhe ta hedhin topin/lodrën në shportën bosh. Iu tregojmë që kemi vendosur tre çmime dhe secili do të vlerësohet sipas kërkesave të secilit çmim. Loja përfundon në kohën e caktuar. Edukatorja siguron që të gjithë fëmijët kanë kërcyer së paku nga 3-4 herë në të dy drejtimet.</p> <p>Në fund ndahen çmimet.</p>
<b>REFLEKTIMI</b>	Gjysma e fëmijëve kërcyen nëpër rrathë. Gjysma tjetër kërcenin jashtë rrathëve. Aktiviteti u integrua me zhvillimin e të dëgjuarit dhe të folurit, standardi 2- fëmija tregon aftësi për të dëgjuar dhe kuptuar gjuhën e folur; me zhvillimin emocional, standardi 2 & 3- fëmija përjeton, njeh dhe shpreh emocionet dhe manifeston aftësi të vetërregullimit të emocioneve; me shkencën, standardi 4 -fëmija mëson për njerëzit si qenie shoqërore; me zhvillimin matematikor, standardi 3-fëmija klasifikon, grupon dhe krahason sende dhe objekte.



## Fusha e zhvillimit të: **Gjuha dhe komunikimi**



### MODEL PLANIFIKIMI

<p style="text-align: center;"><b>6 - 18 MUAJ</b></p>	<p><b>TEMA</b> <b>BOTA E GJALLË</b></p>
<p><b>NËNFUSHA</b></p>	<p><b>Baza fillestare e të lexuarit</b></p>
<p><b>STANDARDI</b></p>	<p>Fëmija e kupton rëndësinë e të lexuarit</p>
<p><b>TREGUESI</b></p>	<p>Fëmija tregon me fjalë disa figura në librin e ilustruar</p>
<p><b>PLANIFIKIMI I AKTIVITETIT TË TË MËSUARIT</b></p>	<p><b>Nëntema:</b> Kafshët</p> <p><b>Rezultati i pritur:</b> Fëmijët thonë emrin e së paku dy kafshëve që shohin në fotografi</p> <p><b>Materialet dhe mjetet:</b> Libra me ilustrime të kafshëve të ndryshme, fotografi të kafshëve, ilustrime të kafshëve</p> <p><b>Organizimi i aktivitetit:</b> Edukatorja ulet së bashku me fëmijët në rreth. Nëpërmjet pyetjeve fillon diskutimin me fëmijë, lidhur me kafshët. Disa pyetje të cilat mund t'i parashtrojë janë: A ju pëlqejnë kafshët? Cila kafshë ju pëlqen më shumë? A mund të imitoni kafshën tuaj të dashur? etj. Atëherë iu thotë që sot do t'i shohim disa libra dhe fotografi me kafshë. Merr disa libra me ilustrime të kafshëve të ndryshme, fotografi të kafshëve, ilustrime të kafshëve (të gjitha këto i ka bërë gati më herët) dhe i vendos në mes të fëmijëve. Edukatorja nxit fëmijët që t'i shikojnë ato fotografi e ilustrime, si dhe t'i shfletojnë librat me kafshë. Gjatë tërë kohës edukatorja bashkëvepron me fëmijët dhe i pyet ata se cila kafshë është ajo që po e shohin, po ashtu bisedon me ta për kafshët. Në fund edukatorja e merr njërin prej librave të ilustruar me kafshë dhe duke i shfletuar faqet i nxit fëmijët të thonë emrin e kafshëve të cilat i shohin.</p>
<p><b>REFLEKTIMI</b></p>	<p>Shumica e fëmijëve përsëritën së paku nga dy emra të kafshëve. Disa fëmijë vetëm imitonin se si bën kafsha që e shihnin në fotografi, por nuk ishin në gjendje t'ia thonin emrin. Gjatë aktivitetit pati gjithëpërfshirje të fëmijëve. Gjatë këtij aktiviteti është bërë ndërlidhja me Qasja ndaj të mësuarit dhe Zhvillimi njohës dhe njohuritë e përgjithshme.</p>





Temat mund të jenë mujore, projekte tematike apo tema javore

2 - 3 VJEÇ

## TEMA SHOQËRIA

### NËNFUSHA 1

#### Të dëgjuarit dhe të folurit

### STANDARDI 2

Fëmija tregon aftësi për të dëgjuar dhe kuptuar gjuhëne folur

### TREGUESI

Fëmija i përgjigjet kërkesës për të bërë ndonjë veprim

### PLANIFIKIMI I AKTIVITETIT TË TË MËSUARIT

**Nëntema:** Kënga “Nëse je i lumtur..”

**Rezultati i pritur:** Fëmijët përplasnin duart, këmbët dhe duartrokasnin.

**Materialet dhe mjetet:** Ambienti i brendshëm ose i jashtëm i kopshtit (varësisht nga moti)

#### Organizimi i aktivitetit:

Edukatorka së bashku me fëmijët formon rrethin. Edukatorka fillon bisedën me fëmijë duke i pyetur: Cilët janë shokët tuaj? Cilat lojëra i luani me ta? A jeni të lumtur kur kaloni mirë me ta? A zemëroheni ndonjëherë me shokët dhe pse? etj. Në vazhdim, ajo iu tregon fëmijëve që do të këndojë një këngë të re. Fëmijët duhet ta dëgjojnë së pari këngën e kënduar nga edukatorja, e pastaj duhet të veprojnë ashtu siç kërkohet gjatë këngës.

Edukatorka fillon të këndojë këngën: “Nëse je vërtet i lumtur...”, përplas duart, nëse je vërtet i lumtur dhe fytyra t’ia tregojë, nëse je vërtet i lumtur përplas duart. Pastaj vazhdon me tekstin e njëjtë, por në vend të duarve thotë përplas këmbët, duartrokite dhe në fund të tria pëmjetëherë. Pasi që së pari ka kënduar dhe modeluar veprimet që kërkohen në këngë, atëherë fillon këndimin prapë dhe fëmijët e përcjellin me lëvizje siç kërkohet. Fëmijët njëkohësisht edhe mund të këndojnë së bashku me edukatoren nëse e kanë të njohur këngën. Në fund edukatorja i pyet nxënësit se si janë ndjerë gjatë këtij aktiviteti me fokus në krijimin e një shoqërie të mirë mes tyre.

Jepni udhëzime të qarta, të shkurtra dhe të sakta!

### REFLEKTIMI

Të gjithë fëmijët kryenin veprimet që kërkoheshin në këngë.

Gjatë aktivitetit u krijua një atmosferë shumë pozitive dhe të gjithë fëmijët ishin të angazhuar.

Gjatë këtij aktiviteti është bërë ndërlidhja me:

- Shëndeti fizik dhe zhvillimi lëvizor në Nënfisha 3, Standardi 1, Treguesi 1.
- Nënfisha Shprehja e kreativitetit, Standardi 2, Treguesi 1.



Kërkoni ide nga fëmijët dhe prindërit në përcaktimin e temave

<p><b>3 – 4 VJEÇ</b></p>	<p><b>TEMA</b> <b>PRANVERA</b></p>
<p><b>NËNFUSHA 3</b></p>	<p><b>Baza fillestare e të shkruarit</b></p>
<p>STANDARDI 1</p>	<p>Fëmija shfaq aftësi për të shkruar simbole dhe shenja të ndryshme</p>
<p>TREGUESI</p>	<p>Kopjon diçka që i pëlqen në formë të dhënë (p. sh. një figurë ose ndonjë shenjë tjetër)</p>
<p>Për të mbërritur këtë tregues, ju mund të zhvilloni 10-12 aktivitete. Ju duhet vetëm të sfidoni fëmijët duke i bërë format më të vështira</p> <p><b>PLANIFIKIMI I AKTIVITETIT TË TË MËSUARIT</b></p>	<p><b>Nëntema:</b> Lulet</p> <p><b>Rezultati i pritur:</b> Fëmijët vizatojnë lulen sipas shembullit të dhënë</p> <p><b>Materialet dhe mjetet:</b> Fletët e bardha, fletët me vizatim të lules, lapsat dhe ngjyrat</p> <p><b>Organizimi i aktivitetit:</b> Edukatorja paraprakisht përgatit fletët ku është vizatuar dhe ngjyrosur një lule. Fletët e bardha, lapsat dhe ngjyrat i vendos në tavolinat e fëmijëve. Edukatorja fillon diskutimin me fëmijët lidhur me pranverën. I pyet: Në cilën stinë jemi?, Si është natyra në pranverë?, Cilat lule ju pëlqejnë?, A kujdeseni ju për lulet?, etj. Atëherë i ndan fëmijët në grupe, dhe i nxit që të vizatojnë dhe të ngjyrosin një lule të ngjashme me lulen që e shohin. Stimulon fëmijët që të përdorin cilëndo ngjyrë që dëshirojnë ata në ngjyrosjen e lules. Përderisa fëmijët janë duke punuar, edukatorja i lavdëron për punën e tyre. Në fund, të gjitha punimet e fëmijëve, edukatorja së bashku me fëmijët i vendosin në mur dhe i shikojnë në formë të ekspozitës së luleve.</p>
<p><b>REFLEKTIMI</b></p>	<p>Të gjithë fëmijët, sipas mënyrës së vet, vizatuan dhe ngjyrosën lulen Gjatë aktivitetit fëmijët ishin bashkëpunues Gjatë këtij aktiviteti është bërë ndërlidhja me Shprehja e kreativitetit, zhvillimin e muskujve fine dhe koordinimit sy-dorë dhe Zhvillimi njohës dhe njohuritë e përgjithshme.</p>

 <p>4-5 VJEÇ</p>	<p>TEMA <b>KOPSHTI IM</b></p>
<p><b>NËNFUSHA 3</b></p>	<p><b>Baza fillestare e të shkruarit</b></p>
<p>STANDARDI 1</p>	<p>Fëmija shfaq aftësi për të shkruar simbole dhe shenja të ndryshme</p>
<p>TREGUESI</p>	<p>Fëmija shkruan ose vizaton forma të ndryshme</p>
<p>PLANIFIKIMI I AKTIVITETIT TË TË MËSUARIT</p>	<p><b>Nëntema:</b> Vizatojmë së bashku</p> <p><b>Rezultati i pritur:</b> Fëmijët vizatojnë objekte të sallës</p> <p><b>Materialet dhe mjetet:</b> Letra flip-charti, lapsa dhe ngjyra për secilin grup</p> <p><b>Organizimi i aktivitetit:</b> Edukatorja me të gjithë fëmijët bisedon për gjërat që i kanë në sallën e tyre. Gjatë bisedës iu parashtron pyetje se a i ndajnë me njëri-tjetrin lodrat, librat, ngjyrat etj., për të nxjerrë mesazhin e bashkëpunimit. Atëherë iu thotë që sot do të punojmë në grupe. I nxit të gjithë fëmijët që në grupe, në letren e flip-chartit, të vizatojnë gjëra të ndryshme të mjedisit ku janë. Gjatë tërë kohës, edukatorja e përcjell punën e grupeve, i inkurajon për pjesëmarrje të gjithë fëmijët, i stimulon kur hasin vështirësi, i lavdëron për punën që bëjnë, i nxit për bashkëpunim, i pyet se çka janë duke vizatuar etj. Në fund të gjitha punimet, së bashku me fëmijët i vendos në mur dhe i gjithë grupi i shikon dhe diskutojnë lidhur me to. Edukatorja e përmbyll aktivitetin duke i lavdëruar për bashkëpunimin dhe dashurinë e treguar ndaj njëri-tjetrit.</p>
<p>REFLEKTIMI</p>	<p>Të gjithë fëmijët u angazhuan gjatë aktivitetit dhe vizatuan së paku nga një objekt në fletën e përbashkët. Gjatë aktivitetit fëmijët ndihmonin njëri-tjetrin. Gjatë këtij aktiviteti është bërë ndërlidhja me Zhvillimi njohës dhe njohuritë e përgjithshme dhe Qasja ndaj të mësuarit.</p>

Shfrytëzoni reflektimin në këtë aktivitet, për të planifikuar aktivitetin pasardhës!

Siguroni lidhmërinë ndërfaqshore sepse vetëm kështu stimuloni zhvillimin e tërësishëm të fëmijëve! 😊

5 - 6 VJEÇ

TEMA  
PËRRALLAT



NËNFUSHA 1

Të dëgjuarit dhe të folurit

STANDARDI 4

Fëmija shpreh aftësi kreative gjuhësore (shprehëse me fjalë)

TREGUESI

Fëmija thur përralla të ndryshme që kanë përmbajtje të strukturuar mirë dhe me një përfundim të lumtur

PLANIFIKIMI I  
AKTIVITETIT TË TË  
MËSUARIT

**Nëntema:** Unë jam autori

**Rezultati i pritur:** Fëmijët plotësojnë njëri-tjetrin në tregimin e një përralle

**Materialet dhe mjetet:** Kukulla për secilin fëmijë, një kukull - bebe

**Organizimi i aktivitetit:**

Fëmijët udhëzohen që secili të marrë një kukull nga këndi i kukullave dhe të vijnë në rreth. Po ashtu edhe edukatorja ka një kukull – bebe në dorë.

Pasi që flasin pak për përrallat, edukatorja u thotë fëmijëve: “Kjo bebe nuk do të flejë pa i rrefyer një përrallë. A mund t’ua tregoni kukullave tuaja një përrallë?”

Inkurajohen fëmijët që njëri të fillojë të tregojë një përrallë nëpërmjet kukullës së dorës, pastaj të tjerët me radhë të vazhdojnë të plotësojnë përrallën. Aktiviteti vazhdon derisa të gjithë fëmijët të kenë mundësi të jenë pjesë e tregimit të përrallës.

Në fund edukatorja i falenderon fëmijët, të cilët i kanë treguar një përrallë kukullës – bebe.

REFLEKTIMI

9 fëmijë morën pjesë në tregimin e një përralle me përmbajtje të strukturuar mirë.

4 fëmijë arritën që pjesërisht të marrin pjesë në tregimin e përrallës

2 fëmijë nuk arritën që të vazhdonin përrallën

Gjatë këtij aktiviteti pati ndërlidhje me Fusha e zhvillimit emocional dhe social, Qasja ndaj të mësuarit, Zhvillimi njohës dhe njohuritë e përgjithshme.

Fëmijët ishin shumë entuziastë për t’i treguar një përrallë “bebes” dhe e dëgjonin njëri-tjetrin me shumë kuriozitet.

## Fusha: **Zhvillimi social dhe emocional**

Marrë nga planifikimi vjetor, mujor, apo ai javor i institucionit

MODEL PLANIFIKIMI

I REFEROHEMI SZHMFH



<p><b>6 - 18 MUAJ</b></p>	<p>TEMA <b>TRUPI</b></p>
<p><b>NËNFUSHA</b></p>	<p><b>Zhvillimi emocional</b></p>
<p>STANDARDI 2</p>	<p>Fëmija demonstroi se njeh konceptin për veten.</p>
<p>TREGUESI</p>	<p>Fëmija njeh disa pjesë të trupit kur i kërkohet nga të tjerët.</p>
<p>PLANIFIKIMI I AKTIVITETIT TË TË MËSUARIT</p> <p><i>Aktiviteti duhet të organizohet në mënyrë të tillë që i përgjigjet qëllimit të tij. Siguroni që fëmijët të përfshihen të gjithë.</i></p>	<p><b>Nëntema:</b> Fytyra ime</p> <p><b>Rezultati i pritur:</b> Shfaq interes për objektet e ofruara</p> <p><b>Materialet dhe mjetet:</b> Kukulla anatomike, apo fotografi.</p> <p><b>Organizimi i aktivitetit:</b></p> <p>Edukatorja duhet të shpjegojë me zë të lartë, pjesët e fytyrës duke i prekur me gishtin e saj dhe duhet ta përsërisë disa herë. Më pas ajo inkurajon fëmijën të bëjë përputhjen e gishtit me pjesën e fytyrës së identifikuar nga edukatorja. Ky aktivitet mund të shoqërohet me muzikë apo këngë, e cila tregon pjesët e fytyrës.</p> <p>Edukatorja siguron që të gjithë fëmijët të marrin pjesë në aktivitet, duke i ndihmuar ata që nuk harrojnë të tregojnë pjesën e fytyrës sipas udhëzimit të saj.</p> <p>Edukatorja mund të bëjë kombinimin e fëmijëve në mënyrë që ato të tregojnë pjesët e fytyrës në shokun apo shoqen e vendosur përballë. Për shkak të moshës së fëmijëve ky aktivitet duhet të bëhet me kujdes në mënyrë që fëmijët të mos lëndojnë njëri-tjetrin gjatë demonstrimit. Nëse edukatorja vlerëson që fëmija nuk është i sigurt të tregojë pjesët e fytyrës së shokut apo shoqes, përdor kukullën për demonstrim.</p> <p><i>Shkruhet në formën e foljes vepruese konkrete, të matshme, të vëzhgushme</i></p>

## REFLEKTIMI

Gjysma e fëmijëve ishin në gjendje të tregonin pjesët e fytyrës.  
Tre prej fëmijëve mund të tregonin pjesët në kukull dhe dy nga fëmijët vetëm kanë shoqëruar aktivitetin përmes vëzhgimit.  
Aktiviteti u integrua me zhvillimin motorik, komunikimin dhe zhvillimin socio-emocional.

### ***Jepuni përgjigje këtyre pyetjeve:***

- Sa fëmijë e realizuan rezultatin e pritur?
- Me cilat fusha u integrua aktiviteti?
- Sa u sigurua gjithëpërfshirja e fëmijëve?
- Reflektimi shkruhet pasi që të mbarojë aktiviteti!

 <p>18 - 24 MUAJ</p>	<p>TEMA <b>MIQËSIA</b></p>  <p>MODEL PLANIFIKIMI</p>
<b>NËNFUSHA</b>	<b>Zhvillimi emocional</b>
STANDARDI 2	Fëmija demonstroi se njeh konceptin për veten
TREGUESI	Fëmija tregon emrin e vet dhe sa vjet i ka
PLANIFIKIMI I AKTIVITETIT TË TË MËSUARIT	<p><b>Nëntema:</b> Shokët e mi në kopsht</p> <p><b>Rezultati i prituri:</b> Fëmija identifikon foton e tij</p> <p><b>Materialet:</b> Hamer me fotot e të gjithë fëmijëve të grupit.</p> <p><b>Organizimi i aktivitetit:</b> Në një vend të dukshëm vendoset hameri me fotot e fëmijëve. Edukatorja i pyet fëmijët që të identifikojnë foton e tyre dhe të tregojnë si e kanë emrin dhe sa vjeç janë. Ndërkohë që zhvillohet aktiviteti fëmijët pyeten se pranë kujt duan ta vendosin foton e tyre dhe të thonë emrin e shokut apo shoqes.</p>
REFLEKTIMI	Pothuajse të gjithë fëmijët identifikuan foton e tyre dhe një pjesë e tyre nuk qenë në gjendje të identifikonin shokun e ngushtë. Ky aktivitet integron Zhvillimin njohës me Zhvillimin social dhe emocional, si dhe atë fizik.

**Jepuni përgjigje këtyre pyetjeve:**

- Sa fëmijë e realizuan rezultatin e prituri?
- Me cilat fusha u integrua aktiviteti?
- Sa u siguria gjithpërfshirja e fëmijëve?
- Reflektimi shkruhet pasi që të mbarojë. aktiviteti!

MODEL PLANIFIKIMI


<p>2 - 3 VJEÇ</p>	<p>TEMA <b>PËRKUJDESJA PËR TË TJERËT</b></p>
<p><b>NËNFUSHA</b></p>	<p><b>Zhvillimi emocional</b></p>
<p>STANDARDI 2</p>	<p>Fëmija mund të manifestojë aftësi të vetërregullimit të emocioneve.</p>
<p>TREGUESI</p>	<p>Fëmija tregon dashuri për fëmijët e tjerë që janë më të vegjël.</p>
<p>PLANIFIKIMI I AKTIVITETIT TË TË MËSUARIT</p>	<p><b>Nëntema:</b> Kështjella e të vegjëlve</p> <p><b>Rezultati i pritur:</b> Fëmijët ndihmojnë të vegjlit</p> <p><b>Materialet dhe mjetet:</b> Kocka të drurit, kukulla me madhësi të ndryshme, kafshë të plastikës si dhe mjete për piknik.</p> <p><b>Organizimi i aktivitetit:</b> Edukatorkja fillimisht tregon një përrallë për disa fëmijë të vegjël të cilët i zë shiu gjatë rrugës për në piknik. Më pas inkurajon fëmijët të ndërtojnë kështjellat me kockat e drurit. Pasi të ndërtojnë kështjellat i kërkon fëmijëve të ndihmojnë të vegjlit (kukullat apo kafshët) që t'i vendosin në kështjellë që të mos frikësohen nga shiu. Ata inkurajohen t'i vënë emra personazheve të tyre. Mbas mbarimit të shiut të gjithë shkojnë në piknik.</p>
<p>REFLEKTIMI</p>	<p>Fushat e integruara: shëndeti fizik dhe zhvillimi lëvizor, gjuha dhe komunikimi; zhvillimi social dhe emocional; kreativiteti.</p>

**Jepuni përgjigje këtyre pyetjeve:**

- Sa fëmijë e realizuan rezultatin e pritur?
- Me cilat fusha u integrua aktiviteti?
- Sa u sigurua gjithpërfshirja e fëmijëve?
- Reflektimi shkruhet pasi që të mbarojë. aktiviteti!



## MODEL PLANIFIKIMI

 <p>3 - 4 VJEÇ</p>	<p>TEMA <b>RESPEKTI</b></p>
<p><b>NËNFUSHA</b></p>	<p><b>Socio- emocionale</b></p>
<p>STANDARDI 2</p>	<p>Fëmija mund të ndërveprojë me personat përreth.</p>
<p>TREGUESI</p>	<p>Fëmija fillon të bashkëpunojë me të tjerët gjatë lojës, jep dhe merr sende</p>
<p>PLANIFIKIMI I AKTIVITETIT TË TË MËSUARIT</p>	<p><b>Nëntema:</b> Si të ndihmojmë të tjerët</p> <p><b>Rezultati i pritur:</b> fëmijët japin ide si të zgjidhin në mënyrën e tyre një problem</p> <p><b>Materialet dhe mjetet:</b> dorëza të leckës, foto me situata të ndryshme (dy fëmijë përulohen për lodrën, një fëmijë handikep që nuk luajnë me të, etj.)</p> <p><b>Organizimi i aktivitetit:</b> Fëmijët e vendosur në formë rrethi dhe të gjithë vendosin një dorëzë në dorë që ka një fytyrë të vizatuar. Mësuesja këndon me ritëm " Ne jemi zgjidhësit e problemeve". Më pas ajo tregon një foto, ku dy fëmijë po përulohen me njëri-tjetrin dhe pyeten fëmijët se çfarë duhet të bëjnë për ta zgjidhur atë problem. Kur fëmija vendos të flasë ndërron dorëzën me fëmijën tjetër dhe së bashku flasin se si do ta zgjidhin problemin.</p> <p>E njëjta vazhdon me foton. ku fëmija me nevoja speciale, nuk është përfshirë në lojë. Fëmijët inkurajohen nga edukatorja të tregojnë se si do ta ndihmojnë fëmijën me nevoja të jetë pjesë e aktiviteteve të tyre.</p>
<p>REFLEKTIMI</p>	<p>Të gjithë fëmijët morën pjesë në aktivitet, vetëm tre prej tyre nuk arritën të japin ide për zgjidhjen e problemit. Fushat e integruara arti, shëndeti fizik dhe zhvillimi lëvizor, gjuha dhe komunikimi, zhvillimi social dhe emocional, kreativiteti.</p>

## MODEL PLANIFIKIMI

<p style="text-align: center;"><b>4 - 5 VJEÇ</b></p>	<p><b>TEMA</b> <b>EMOCIONET</b></p>
<p><b>NËNFUSHA</b></p>	<p><b>Zhvillimi emocional</b></p>
<p><b>STANDARDI 2</b></p>	<p>Fëmija mund të manifestojë aftësi të vetërregullimit të emocioneve</p>
<p><b>TREGUESI</b></p>	<p>Fëmija ndan emocionet me të tjerët</p>
<p><b>PLANIFIKIMI I AKTIVITETIT TË TË MËSUARIT</b></p>	<p><b>Nëntema:</b> Katalogu i emocioneve</p> <p><b>Rezultati i pritur:</b> Fëmija emërton emocionet bazike</p> <p><b>Materialet dhe mjetet:</b></p> <p>Në një hamer vendosen vizatimet e disa fytyrave që kanë emocione të ndryshme, ose mund të përdoret një libër me figura. Lapsa, fleta të bardha.</p> <p><b>Organizimi i aktivitetit:</b></p> <p>Fillimisht fëmijët ftohen të identifikojnë emocionet e treguara përmes fotografive, të cilat janë të ngjitura në hamer, apo janë të demonstruara në një libër me figura dhe inkurajohen të tregojnë se kur e shfaqin atë emocion. Më pas fëmijët ndahen në grupe për të krijuar katalogun e emocioneve me punimet e tyre. Çdo fëmijë zgjedh të vizatojë emocionin në mënyrën e tij/saj. Me ngjitës krijojnë katalogun.</p>
<p><b>REFLEKTIMI</b></p>	<p>Fushat e integruara arti, shëndeti fizik dhe zhvillimi lëvizor, gjuha dhe komunikimi, zhvillimi social dhe emocional, zhvillimi njohës.</p>

<p>5 - 6 VJEÇ</p>	<p>TEMA <b>ZGJIDHJA E PROBLEMEVE</b></p>
<p><b>NËNFUSHA</b></p>	<p><b>Zhvillimi emocional</b></p>
<p>STANDARDI 2</p>	<p>Fëmija përjeton, njuh dhe shpreh në mënyrë të drejtë emocionet</p>
<p>TREGUESI</p>	<p>Fëmija i shpreh emocionet nëpërmjet lojës, përpiqet të ndihmojë shokun/shoqen</p>
<p>PLANIFIKIMI I AKTIVITETIT TË TË MËSUARIT</p>	<p><b>Nëntema:</b> Bretkosa luftarake</p> <p><b>Rezultati i pritur:</b> Arrijnë të gjejnë një zgjidhje për situatën.</p> <p><b>Materialet dhe mjetet:</b> Libër me figura, ose mund të përdoren vizatime, papets.</p> <p><b>Organizimi i aktivitetit:</b> Fëmijët e vendosur në formë rrethi dëgjojnë tregimin nga edukatorja. Ndërkohë për çdo faqe fëmijët japin mendimin rreth emocioneve që identifikojnë. Në momentin e konfliktit mes figurave fëmijët marrin papets dhe fillojnë të demonstrojnë se si do ta zgjidhin konfliktin. Edukatorja duhet të përfshijë të gjithë fëmijët. Në fund të tregimit dhe dramatizimit duhet të tregojnë se çfarë kanë mësuar.</p>
<p>REFLEKTIMI</p>	<p>Integrimi i fushave, kreativiteti, shëndeti fizik, zhvillimi njohës, zhvillimi i komunikimit.</p>

## Fusha: **Zhvillimi njohës dhe njohuritë e përgjithshme**



I REFEROHEMI SZHMFH

MODEL PLANIFIKIMI



Marrë nga planifikimi vjetor, mujor, javor i institucionit

<p><b>6 - 18 MUAJ</b></p>	<p><b>TEMA</b> <b>KAFSHËT</b></p>
<p><b>NËNFUSHA</b></p>	<p><b>Natyra dhe shkenca</b></p>
<p>STANDARDI</p>	<p>Fëmija vëzhgon dhe përshkruan botën e gjallë</p>
<p>TREGUESI</p>	<p>Fëmija fillon të imitojë kafshët</p>
<p>PLANIFIKIMI I AKTIVITETIT TË TË MËSUARIT</p> <p><i>Zgjidhni atë lojë, aktivitet që ju mundëson fëmijëve të zhvillojnë të paktën 6-8 herë veprimin e pritur.</i></p>	<p><b>Nëntema:</b> Vizitori më i ri i kopshtit</p> <p><b>Rezultati i pritur:</b> Fëmija tregon interes për kafshën</p> <p><b>Materialet dhe mjetet:</b> Edukatorja në bashkëpunim me prindërit mund të krijojë mundësi që ndonjë prej fëmijëve, që ka kafshë shtëpiake, ta sjellë për vizitë.</p> <p><b>Organizimi i aktivitetit:</b> Organizohet një ndejë e fëmijëve me vizitorin e ri. Edukatorja krijon mundësinë që të gjithë fëmijët ta prekin, ledhatojnë. Për fëmijët të cilët nuk dëshirojnë ta prekin mund të ofrohen kafshë lodra me pelush.</p>
<p>REFLEKTIMI</p>	<p>Pjesa më e madhe e fëmijëve treguan interes për vizitorin. Ndërkohë dy fëmijë kishin frikë nga vizitori.</p> <p>Fushat e integruara: zhvillimi njohës, komunikimi dhe gjuha, fusha emocionale.</p>

## FUSHA : *Zhvillimi njohës dhe njohuritë e përgjithshme*

MARRË NGA PLANIFIKIMI  
VJETOR I INSTITUCIONIT

I referohemi SZHMFH

 <p>18-24 MUAJ</p>	<p>TEMA <b>OBJEKTI PERMANENT</b></p>
<p><b>NËNFUSHA</b></p>	<p><b>Të menduarit dhe logjika</b></p>
<p>STANDARDI 1</p>	<p>Fëmija demonstroi aftësinë për të hulumtuar dhe zbuluar ambientin përreth</p>
<p>TREGUESI</p>	<p>Fëmija shikon brenda objekteve. Kërkon objektet e fshehura.</p>
<p>PLANIFIKIMI I AKTIVITETIT TË TË MËSUARIT</p>	<p><b>Nëntema:</b> Tabela e fitores</p> <p><b>Rezultati i pritur:</b> Fëmija fut objektet brenda në kuti</p> <p><b>Materialet dhe mjetet:</b> Kutit kartoni e cila ka formë të ndryshme gjeometrike në sipërfaqen e tyre dhe ku objektet mund të kalojnë në brendësi të saj.</p> <p><b>Organizimi i aktivitetit:</b> Edukatoja fillon aktivitetin duke ndarë fëmijët në grupe, ofruar kutitë dhe objekte të cilat mund të depërtojnë vrimat e krijuara me forma gjeometrike të ndryshme, dhe ftohen fëmijët të fusin objektet brenda. Pasi të jenë fshehur të gjitha objektet, fëmijët së bashku me edukatoren hapin kutitë dhe përsërisin lojën disa herë.</p>
<p>REFLEKTIMI</p>  <p><i>Zgjidhni atë lojë, aktivitet që ju mundëson fëmijëve të zhvillojnë të paktën 8-10 herë veprimin e nritur.</i></p>	<p>Vetëm katër fëmijë mundën t'i fusnin objektet pa ndihmën e një fëmije tjetër apo edukatores. Integrimi i fushave: shëndeti fizik dhe zhvillimi lëvizor (standardi 1- fëmija tregon aftësinë të përdorë duart dhe gishtat, nënfusha 2 – zhvillimi i aftësive lëvizore), gjuha dhe komunikimi (Nënfusha 1- të dëgjuarit dhe të folurit, Standardi 2- fëmija tregon aftësi për të dëgjuar dhe kuptuar gjuhën e folur); zhvillimi social dhe emocional (Nënfusha 2, Standardi 3- fëmija mund të tregojë aftësi të vetëregullimit të emocioneve) zhvillimi matematikor (standardi 2- fëmija zhvillon të kuptuarit e formave themelore gjeometrike).</p>

Reflektimi shkruhet pasi që të mbarojë aktiviteti!

FUSHA : **Zhvillimi njohës  
dhe njohuritë e  
Përgjithshme**

<p style="text-align: center;"><b>2 - 3 VJEÇ</b></p>	<p><b>TEMA KAFSHËT</b></p>
<p><b>NËNFUSHA</b></p>	<p><b>Shkenca (natyra dhe shoqëria)</b></p>
<p>STANDARDI 4</p>	<p>Fëmija mëson njeriun si qenie sociale</p>
<p>TREGUESI</p>	<p>Fëmija fillon të përshkruajë ngjashmërinë në mes të rriturve dhe fëmijëve.</p>
<p>PLANIFIKIMI I AKTIVITETIT TË TË MËSUARIT</p>	<p><b>Nëntema:</b> Kopshti zoologjik</p> <p><b>Rezultati i pritur:</b> Fëmija emërton kafshët e mëdha si prindër dhe të voglat si fëmijë.</p> <p><b>Materialet dhe mjetet:</b> tavolinë, kafshë të plastikës, të cilat kanë së paku pesë grup të kafshëve (dy kafshë të mëdha dhe së paku dy të vogla), plastelinë si dhe materiale të tjera ndihmëse.</p> <p><b>Organizimi i aktivitetit:</b> Edukatorja së bashku me fëmijët punojnë rreth tavolinës për të ndërtuar një kopsht zoologjik me ndihmën e plastelinës, mjeteve të ndryshme që janë në dispozicion të kopshtit (shishe, kartona, lule etj.), të gjithë fëmijët duhet të përgatisin diçka për kopshtin zoologjik. Kur mjedisi të jetë gati fëmijëve ju ofrohen kafshet e plastikës dhe ju kërkohet t'i vendosin sipas familjeve në kopshtin e krijuar. Edukatorja fton fëmijët të vendosen rreth tavolinës dhe të emërtojnë anëtarët e familjes së kafshëve.</p>
<p>REFLEKTIMI</p>	<p>Fushat e integruara, shëndeti fizik dhe zhvillimi lëvizor, gjuha dhe komunikimi, zhvillimi social dhe emocional, zhvillimi matematikor, kreativiteti.</p>

I referohemi SZHMFH

FUSHA : *Zhvillimi njohës  
dhe njohuritë e  
Përgjithshme*

<p style="text-align: center;"><b>3 - 4 VJEÇ</b></p>	<p><b>TEMA AMBIENTI</b></p>
<p><b>NËNFUSHA</b></p>	<p><b>Shkenca dhe natyra</b></p>
<p>STANDARDI 1</p>	<p>Fëmija mbledh informata rreth ambientit përmes observimit dhe manipulimit me të</p>
<p>TREGUESI</p>	<p>Fëmija fillon të japë sqarime për marrëdhënien në mes të dy objekteve.</p>
<p>PLANIFIKIMI I AKTIVITETIT TË TË MËSUARIT</p>	<p><b>Nëntema:</b> Kopshti ynë</p> <p><b>Rezultati i pritur:</b> Fëmija bashkon dy objekte dhe i përshkruan.</p> <p><b>Materialet dhe mjetet:</b> Në hapësirën e kopshtit shpërndahen objekte të cilat kanë lidhshmëri me njëri-tjetrin (fustan dhe kukull, rrotë dhe makinë, kuti që futen tek njëra-tjetra etj.) dhe përgatitet tribuna, ku do të vendosen objektet.</p> <p><b>Organizimi i aktivitetit:</b> Edukatoja e fillon aktivitetin duke ju shpjeguar fëmijëve që duhet të sillen në hapësirën e kopshtit dhe të gjejnë dy objekte të cilat bashkohen me njëra-tjetrën dhe t'i vendosin në tribunën e sendeve me vlerë. Pasi që objektet janë vendosur në tribunë ata duhet t'i tregojnë fëmijëve të tjerë se cili është produkti i tyre.</p>
<p>REFLEKTIMI</p>	<p>Fushat e integruara: shëndeti fizik dhe zhvillimi lëvizor, gjuha dhe komunikimi, zhvillimi social dhe emocional, zhvillimi njohës.</p>

4 - 5 VJEÇ

FUSHA : *Zhvillimi njohës  
dhe njohuritë e  
Përraiithshme*

TEMA  
**HIGJIENA PERSONALE**

<b>NËNFUSHA</b>	<b>Shkenca dhe natyra</b>
STANDARDI 1	Fëmija mëson për njerëzit si qenie njerëzore
TREGUESI	Fëmija realizon disa aktivitete të kujdesit vetanak në mënyrë të pavarur.
PLANIFIKIMI I AKTIVITETIT TË TË MËSUARIT	<p><b>Nëntema:</b> Higjiena e dhëmbëve</p> <p><b>Rezultati i pritur:</b> Fëmija përgatitë furçën për larje të dhëmbëve vetë.</p> <p><b>Materialet dhe mjetet:</b> Foto të fëmijëve duke pastruar dhëmbët, furqa, pastë e dhëmbëve. Një foto duhet të jetë e një fëmije me nevoja speciale.</p> <p><b>Organizimi i aktivitetit:</b> Edukatoja e fillon aktivitetin duke iu shpjeguar fëmijëve procedurat e pastrimit të dhëmbëve. Fëmijët ftohen të përgatisin furçat dhe pastaj inkurajohen të pastrojnë dhëmbët. Pasi ta kenë përfunduar aktivitetin fëmijët ftohen të flasin se si duhet të ndihmojnë fëmijën me nevoja speciale. Fëmijët mund të këndojnë ndonjë këngë që lidhet me higjienën. Ndërkohë ndihmojnë njëri-tjetrin gjatë larjes së dhëmbëve për ndonjë fëmijë që ka nevojë.</p>
REFLEKTIMI	Fushat e integruara: shëndeti fizik dhe zhvillimi lëvizor, gjuha dhe komunikimi, zhvillimi social dhe emocional.



5-6 VJEÇ

TEMA  
**NJERIU DHE NATYRA**

FUSHA : **Zhvillimi  
njohës dhe njohuritë  
e përaiithshme**

<b>NËNFUSHA</b>	<b>Shkenca ( natyra dhe shoqëria)</b>
STANDARDI 1	Fëmija demonstroi aftësinë për të hulumtuar dhe zbuluar ambientin përreth
TREGUESI	Fëmija sqaron marrëdhëniet e thjeshta që ekzistojnë në mes bimëve, kafshëve dhe ambientit.
PLANIFIKIMI I AKTIVITETIT TË TË MËSUARIT	<p><b>Nëntema:</b> Çokollata ime</p> <p><b>Rezultati i prituri:</b> Fëmija demonstroi ndërlidhjen në mes të njeriut dhe kafshëve.</p> <p><b>Materialet dhe mjetet:</b> Veshje e lopës, tavolinë, peshore, shishe, mjete të kuzhinës.</p> <p><b>Organizimi i aktivitetit:</b> Edukatoja fillimisht tregon se si do të përgatitet çokolata, dhe jep shpjegime se cilat janë produktet që ata do të duhet të mbledhin. Një fëmijë luan rolin e fermerit, një që blen qumështin, dikush blen produktet e tjera në dyqanin e hapur në një kënd të dhomës dhe fëmijët e tjerë do të përgatisin recetën e çokollatës me ndihmën e edukatores.</p>
REFLEKTIMI	Gjuha dhe komunikimi, zhvillimi social dhe emocional, zhvillimi matematikor, zhvillimi njohës.

## Fusha: **Zhvillimimatematikor**



### MODEL PLANIFIKIMI

<p><b>6 - 18 MUAJ</b></p>	<p>TEMA <b>KOMUNIKACIONI</b></p>
<p><b>NËNFUSHA</b></p>	<p><b>Zhvillimi matematikor</b></p>
<p>STANDARDI 2</p>	<p>Fëmija zhvillon të kuptuarit e figurave themelore gjeometrike, hapësirës dhe matjes së madhësive</p>
<p>TREGUESI 1</p>	<p>Fëmija vëzhgon figurat themelore (trekëndëshin, katrorin, rrethin)</p>
<p>PLANIFIKIMI I AKTIVITETIT TË TË MËSUARIT</p>	<p><b>Nëntema:</b> Treni</p> <p><b>Rezultati i pritur:</b> Fëmijët dallojnë formën e katrorit dhe trekëndëshit gjatë lojës</p> <p><b>Materialet dhe mjetet:</b> Lodra plastike në formë katrori dhe trekëndëshi.</p> <p><b>Organizimi i aktivitetit:</b> Edukatorka vendos në dysheme mjaftueshëm lodra plastike në formë katrori dhe trekëndëshi. Inkurajon fëmijët që të luajnë me to, duke qenë edhe vetë pjesëmarrëse në lojë. Edukatorka së bashku me fëmijët formon trenin dhe figura të ndryshme me këto lodra, si dhe gjatë tërë kohës bisedon me fëmijët, duke u kërkuar një katror, një trekëndësh e kështu me radhë. Njëkohësisht ajo vëzhgon, stimulon, udhëzon, përforcon, lavdëron fëmijët gjatë lojës.</p>
<p>REFLEKTIMI</p>	<p>Shumica e fëmijëve i dallonin se cilat lodra ishin katrorë dhe cilat trekëndësha X, Y dhe Z nuk e bënin dallimin e trekëndëshit kur ia kërkoja. Të gjithë fëmijët ishin të përfshirë në aktivitet. Gjatë këtij aktiviteti është bërë ndërlidhja me Shëndeti fizik dhe zhvillimi lëvizor, Qasja ndaj të mësuarit, Gjuha dhe komunikimi.</p>




**NËNFUSHA: ZHVILLIMI  
MATEMATIKOR  
MODEL PLANIFIKIMI**


<p><b>18 - 24 MUAJ</b></p>	<p><b>TEMA</b> <b>KOMUNIKACIONI</b></p>
<p><b>NËNFUSHA</b></p>	<p><b>Zhvillimi matematikor</b></p>
<p>STANDARDI 2</p>	<p>Fëmija zhvillon të kuptuarit e figurave themelore gjeometrike, hapësirës dhe matjes së madhësive</p>
<p>TREGUESI 1</p>	<p>Fëmija me ndihmën e të rriturit vendos figurat e thjeshta në vendin përkatës (puzzle apo lodra me forma)</p>
<p>PLANIFIKIMI I AKTIVITETIT TË TË MËSUARIT</p>	<p><b>Nëntema:</b> Makinat</p> <p><b>Rezultati i pritur:</b> Fëmijët vendosin figurat gjeometrike në vendin përkatës (Ky aktivitet është i planifikuar të zhvillohet në muajin maj, kur fëmijët pothuajse e kanë arritur treguesin)</p> <p><b>Materialet dhe mjetet:</b> Lodra me forma të ndryshme gjeometrike dhe sajueset.</p> <p><b>Organizimi i aktivitetit:</b> Eduktorja paraqet para fëmijëve lodrat me forma gjeometrike dhe sajuese. I inkurajon që të luajnë me to, duke i vendosur figurat gjeometrike në vendin përkatës. Ndan fëmijët në grupe me qëllim të nxitjes së punës ekipore dhe bashkëpunimit. Secili grup ka lodra të mjaftueshme me forma gjeometrike. Fëmijët fillojnë lojën dhe përpiqen që të bashkojnë figurën gjeometrike me vendin përkatës. Eduktorja gjatë tërë kohës përcjell punën e fëmijëve, i pyet për punën, i lavdëron kur gjejnë vendin e ndonjë forme, nxit bashkëpunimin në mes tyre, si dhe iu ndihmon kur hasin në vështirësi.</p>
<p>REFLEKTIMI</p>	<p>Shumica e fëmijëve me lehtësi gjenin vendin e figurave gjeometrike. X dhe Y iu duhej ndihmë për të formuar sajuesen. Gjatë këtij aktiviteti është bërë ndërlidhja me Qasja ndaj të mësuarit, Shëndeti fizik dhe zhvillimi lëvizor dhe Gjuha dhe komunikimi.</p>



<p style="text-align: center;"><b>2 - 3 VJEÇ</b></p>	<p><b>TEMA</b> <b>KOMUNIKACIONI</b></p>
<p><b>NENFOSIMI</b></p>	<p><b>Zhvillimi matematikor</b></p>
<p><b>STANDARDI 2</b></p>	<p>Fëmija zhvillon të kuptuarit e figurave themelore gjeometrike, hapësirës dhe matjes së madhësive</p>
<p><b>TREGUESI</b></p>	<p>Fëmija fillon t'i identifikojë objektet sipas formës</p>
<p><b>PLANIFIKIMI I AKTIVITETIT TË TË MËSUARIT</b></p>	<p><b>Nëntema:</b> Semafori</p> <p><b>Rezultati i pritur:</b> Fëmijët identifikojnë rrethin, katrorin dhe trekëndëshin.</p> <p><b>Materialet dhe mjetet:</b> Forma gjeometrike (rrethë, katrorë dhe trekëndësha) të madhësive dhe ngjyrave të ndryshme për të gjithë fëmijët</p> <p><b>Organizimi i aktivitetit:</b> Fillimisht edukatorja zhvillon një bisedë me fëmijët lidhur me semaforin, ngjyrat që i shohin aty dhe format gjeometrike. Pas kësaj, edukatorja secilit fëmijë i jep një set të figurave gjeometrike (rrethit, katrorit, trekëndëshit) të madhësive dhe ngjyrave të ndryshme. Po ashtu një set të njëjtë e merr edhe për vete. Atëherë iu tregon fëmijëve që kur edukatorja merr një figurë në dorë, atëherë ata duhet të gjejnë në setin e tyre figurën e njëjtë dhe ta ngrejnë lart. Vazhdon kështu disa herë me figura të ndryshme. Pas kësaj u jep mundësi fëmijëve që ata të jenë udhëheqës të aktivitetit. Gjatë tërë kohës i inkurajon dhe lavdëron kur e qëllojnë.</p>
<p><b>REFLEKTIMI</b></p>	<p>Shumica e fëmijëve identifikonin rrethin, katrorin dhe trekëndëshin, sipas madhësisë dhe ngjyrës. Disa fëmijë e kishin të vështirë t'i dallonin format gjeometrike. Gjatë aktivitetit kishte gjithëpërfshirje dhe fëmijët ishin shumë entuziastë për detyrën. Gjatë këtij aktiviteti është bërë ndërlidhja me Zhvillimi njohës dhe njohuritë e përgjithshme dhe Shëndeti fizik dhe zhvillimi lëvizor.</p>



 <p><b>3 - 4 VJEÇ</b></p>	<p><b>TEMA</b> <b>FESTAT</b></p>
<b>NËNFUSHA</b>	<b>Zhvillimi matematikor</b>
STANDARDI 1	Fëmija zhvillon të kuptuarit e numrave dhe numërimit
TREGUESI	Fëmija fillon të lidhë numrin me sendet e ndryshme
PLANIFIKIMI I AKTIVITETIT TË TË MËSUARIT	<p><b>Nëntema:</b> Viti i Ri</p> <p><b>Rezultati i pritur:</b> Fëmijët marrin aq objekte sa është numri i dhënë</p> <p><b>Materialet dhe mjetet:</b> Objekte të ndryshme që gjenden në klasë</p> <p><b>Organizimi i aktivitetit:</b> Edukatorja dhe fëmijët formojnë rrethin. Atëherë edukatorja u thotë fëmijëve që do të luajnë një lojë me titull “Babadimri thotë...”, e cila luhet kështu: “Kur unë them: Babadimri thotë t’i sjellësh në mes të dhomës 2 dhurata, ju duhet të shkoni t’i gjeni dhe t’i sillni këtu”. Loja vazhdon me kërkesa të ndryshme dhe me numra të ndryshëm derisa të gjithë fëmijët të kenë rastin të kryejnë porosinë e babadimrit.</p>
REFLEKTIMI	<p>Pothuajse të gjithë fëmijët bënë lidhjen e numrit me objekte.</p> <p>X-it iu nevojiti ndihma për të marrë aq objekte sa iu kërkua.</p> <p>Gjatë aktivitetit pati gjithëpërfshirje.</p> <p>Gjatë këtij aktiviteti është bërë ndërlidhja me Gjuha dhe komunikimi dhe Zhvillimi njohës dhe njohuritë e përgjithshme.</p>





## MARRË NGA PLANIFIKIMI VJETOR I INSTITUCIONIT

4- 5 VJEÇ

### TEMA USHQIMI

<b>NËNFUSHA</b>	<b>Zhvillimi matematikor</b>
STANDARDI 3	Fëmija klasifikon, grupon dhe krahason sende dhe objekte
TREGUESI	Fëmija krahason madhësitë
PLANIFIKIMI I AKTIVITETIT TË TË MËSUARIT	<p><b>Nëntema:</b> Pemët</p> <p><b>Rezultati i pritur:</b> Fëmijët dallonin ku ka më shumë dhe ku ka më pak në grafikun e krijuar</p> <p><b>Materialet dhe mjetet:</b> Grafiku i vizatuar në letër flip-charti, letrat e vogla me pemë të vizatuara në to, ngjytës. Të gjitha këto materiale duhet të përgatiten për tri grupe.</p> <p><b>Organizimi i aktivitetit:</b> Fillimisht edukatorja diskuton me fëmijët për ushqimin. Ajo i pyet: Cilat janë ushqimet e tyre të preferuara? Cilat ushqime duhet t'i hamë më tepër dhe pse? Cilën pemë e hani më me dëshirë? etj. Atëherë edukatorja iu shpjegon që sot do të shohim se cilat janë pemët më të preferuara të grupit tonë, nëpërmjet një aktiviteti të cilin do ta zhvillojmë në grupe. Edukatorja së pari shpjegon aktivitetin, duke vendosur para tërë grupit pemë të ndryshme të vizatuara në letra të vogla katrore. Në anën tjetër edukatorja ka vizatuar në letër flip – charti një grafik të cilin e ka vendosur në mur. Iu thotë fëmijëve që kur të ndaheni në grupe duhet të zgjidhni vizatimin e frutit që iu pëlqen më shumë. Këto vizatime i vendosni në grafik (mollët në një rend, bananet në rendin tjetër, e kështu me radhë). Pasi të sigurohet që fëmijët e kanë kuptuar aktivitetin fëmijët i ndan në grupe. Për secilin grup ka përgatitur materialet e duhura. Fëmijët fillojnë aktivitetin. Gjatë kësaj kohe, edukatorja përcjell punën dhe i lavdëron për angazhimin. Pasi të gjitha grupet e përfundojnë aktivitetin, atëherë fëmijët i nxit që të interpretojnë grafikët nëpërmjet pyetjeve: Cila është pema që i pëlqen më shumë grupit tuaj? Cila është pema që iu pëlqen më pak?</p>

REFLEKTIMI	<p>Shumica e fëmijëve lexonin grafikun e formuar me pemë, dallonin ku ka më shumë dhe ku më pak pemë.</p> <p>X dhe Y nuk mund të interpretonin rezultatet e grafikut.</p> <p>Gjatë këtij aktiviteti është bërë ndërlidhja me: - Gjuha dhe komunikimi, Nënfisha 1, Standardi 3, Treguesi 2- Qasja ndaj të mësuarit, Standardi 5, Treguesi 1.</p>
------------	---

	<p><b>TEMA</b> <b>NJERËZIT</b></p> 
<b>NËNFUSHA</b>	<b>Zhvillimi matematikor</b>
STANDARDI 1	Fëmija zhvillon të kuptuarit e numrave dhe numërimit
TREGUESI	Fëmija numëron me kuptim deri në 10
PLANIFIKIMI I AKTIVITETIT TË TË MËSUARIT	<p><b>Nëntema:</b> Diversiteti</p> <p><b>Rezultati i pritur:</b> Fëmijët thonë numrat 1 deri në 10 gjatë lojës</p> <p><b>Materialet dhe mjetet:</b> Shiriti i numrave në dysheme deri në 10</p> <p><b>Organizimi i aktivitetit:</b> Fillimisht edukatorja bisedon me fëmijët për njerëzit, nëpërmjet disa pyetjeve të cilat vënë në pah diversitetin (p.sh. disa janë të rinj e disa të moshuar, disa të vegjël e disa të mëdhenj, disa të bardhë e disa të zinj, disa me flokë të shkurtër e disa me flokë të gjatë etj.). Së bashku vijmë te qëllimi që t'i respektojmë të tjerët, pavarësisht dallimeve. Biseda gjithnjë zhvillohet në nivel të moshës së fëmijëve. Këtë bisedë e ndërlidh me numrat të cilët në gjithë botën janë të njëjtë dhe vendos në dysheme shiritin e numrave deri në 10. Fillon lojën duke dhënë udhëzimet: "I thotë një fëmijë: Shkel te numri 1. Ec dy hapa para. Te cili numër je tash? Ec edhe dy hapa para. Tani te cili numër je? Shko tre hapa prapa? Cili numër është tash?" Kështu vazhdon edhe me fëmijët e tjerë. Pas një kohe, fëmijët i japin udhëzimet njëri – tjetrit. Edukatorja i lavdëron, i sfidon, i inkurajon gjatë lojës. Loja vazhdon derisa të gjithë fëmijët të kenë pasur mundësinë të luajnë në shiritin e numrave disa herë.</p>
REFLEKTIMI	<p>Të gjithë fëmijët thonin numrat prej 1 deri në 10 gjatë lojës.</p> <p>Fëmijët ishin shumë të angazhuar gjatë aktivitetit.</p> <p>Gjatë këtij aktiviteti është bërë ndërlidhja me fushën: Gjuha dhe komunikimi, Shëndeti fizik dhe zhvillimi lëvizor dhe Zhvillimi social-emocional.</p>

## Fusha: **Artidhe Muzika**

I referohemi SZHMFH

<p><b>6 - 18 MUAJ</b></p>	<p><b>TEMA</b> <b>MUZIKOJMË SË BASHKU</b> (veprimtari a krijim)</p>
<p><b>NËNFUSHA</b></p>	<p><b>KREATIVITETI</b></p>
<p>STANDARDI 2</p>	<p>Fëmija shfaq interesim për muzikën dhe prirje individuale për aktivitete/veprimtari të ndryshme muzikore</p>
<p>TREGUESI</p>	<p>Fëmija bën “muzikë” me lodra të ndryshme</p>
<p>PLANIFIKIMI I AKTIVITETIT TË TË MËSUARIT</p>	<p><b>Nëntema:</b> Tringëllima</p> <p><b>Rezultati i pritur:</b> Përdor objektet lodra për të bërë muzikë</p> <p><b>Materialet dhe mjetet:</b> Lodra që krijojnë tinguj, lodra ritmike (rraketakja, marakasi etj.)</p> <p><b>Organizimi i aktivitetit:</b> I ofrojmë fëmijëve lodra, objekte ose instrumente muzikore të përshtatshme për moshën e tyre. Përpiqemi të sigurojmë për të gjithë fëmijët. Fëmijëve iu demonstrojmë se si objektet, lodrat apo instrumentet mund të krijojnë tinguj dhe i stimulojmë që edhe ata të bëjnë tinguj të tillë. Stimulojmë krijimin e tingujve... (jo zhurmave)</p>
<p>REFLEKTIMI</p>	<p>Pjesa më e madhe e fëmijëve përjetuan ritme dhe melodi të krijuara nga lodrat dhe instrumentet muzikore. Dy nga fëmijët N. &amp; N. kanë qajtur kohë pas kohe, nuk janë ambientuar me aktivitetin. Integrimi i fushave: <b>shëndeti fizik dhe zhvillimi lëvizor</b> standardi 1-fëmija tregon aftësinë të përdorë duart dhe gishtat, nënfusha 2 – zhvillimi i aftësive lëvizore, <b>gjuha dhe komunikimi</b> standardi 2-fëmija tregon aftësi për të dëgjuar dhe kuptuar gjuhën e folur, <b>zhvillimi emocional</b> standardi 2-fëmija përjeton, njeh dhe shpreh emocionet <b>qasja ndaj të mësuarit</b>, standardi 1-fëmija shpreh interes dhe kuriozitet për të mësuar gjëra të reja.</p>


### **Jepuni përgjigje këtyre pyetjeve:**


- Sa fëmijë e realizuan rezultatin e pritur?
- Me cilat fusha u integrua aktiviteti?
- Sa u sigurua gjithëpërfshirja e fëmijëve?
- Reflektimi shkruhet pasi që të mbarojë. aktiviteti!




18- 24 MUAJ

	<b>TEMA</b> <b>KOMUNIKACIONI</b> (veprimtaria krijim – dëgjim)
<b>NËNFUSHA</b>	<b>Kreativiteti</b>
STANDARDI 1	Fëmija demonstroi aftësi të dalloj tinguj të ndryshëm
TREGUESI	Fëmija reagon në muzikë duke bërë lëvizje të ndryshme
PLANIFIKIMI I AKTIVITETIT TË TË MËSUARIT	<p><b>Nëntema:</b> Loja treni</p> <p><b>Rezultati i pritur:</b> imitojnë lëvizjet e trenit</p> <p><b>Materialet dhe mjetet:</b> foto e trenit , cd player, cd,</p> <p><b>Organizimi i aktivitetit:</b>          Edukatorja i mbledh të gjithë fëmijët në rreth, duke ju ofruar foto, vizatime ose ndonjë video ku shihet treni. Pastaj ju jep udhëzimet për lojë dhe i fton që t'i imitojnë lëvizjet e trenit. Edukatorja së bashku me fëmijët këndojnë:  <i>O sa bukur treni</i>  <i>Kalon nëpër mal</i>  <i>Ec treni bukur</i>  <i>Ec e mosu ndal .....</i></p> <p>Fëmijët kapen njëri pas tjetrit duke imituar lokomotivën dhe vagonat e trenit. Pastaj në vijim të aktivitetit edukatorja me një fëmijë mbajnë duart lidhur dhe fëmijët kalojnë mospërmas duke simuluar se janë duke kaluar nëpër tunel.          (Në rast se edukatorja nuk është në gjendje të këndojë këngën është mirë që paraprakisht të sigurohen cd me melodi ose këngë kushtuar trenit).</p>
REFLEKTIMI	Në këtë aktivitet u përfshinë të gjithë fëmijët pasi që aktiviteti ishte tërheqës për ta. Ky aktivitet u integrua me artin, fushën e shëndetit fizik dhe zhvillimi lëvizor, fushën e gjuhës dhe komunikimit, zhvillimi social dhe emocional, zhvillimi matematikor.

 <p>2-3 VJEÇ</p>	<p>TEMA <b>KËNGËT FESTIVE</b> (Veprimtaria dëgjim)</p>
<p><b>NËNFUSHA</b></p>	<p><b>Kreativiteti</b></p>
<p>STANDARDI 2</p>	<p>Fëmija shfaq interesim për muzikën dhe prirje individuale për aktivitete/veprimtari të ndryshme muzikore</p>
<p>TREGUESI</p>	<p>Fëmija këndon në mënyrën e vet</p>
<p>PLANIFIKIMI I AKTIVITETIT TË TË MËSUARIT</p>	<p><b>Nëntema:</b> Dëshira ime</p> <p><b>Rezultati i pritur:</b> Këndojnë sipas imagjinatës së tyre</p> <p><b>Materialet dhe mjetet:</b> cd playeri, cd të ndryshme</p> <p><b>Organizimi i aktivitetit:</b> Përmes cd playerit fëmijët dëgjojnë këngë të ndryshme që i përgjigjen moshës së tyre (mundësisë përjetuese dhe interpretuese) duke i respektuar edhe kërkesat-dëshirat e fëmijëve për këngët që i preferojnë. Gjatë tërë kohës këngët i shoqërojmë me vallëzim spontan. Pjesën tjetër të aktivitetit kërkojmë prej tyre që të këndojnë këngën sipas mënyrës së tyre të interpretimit. Kjo pjesë mund të bëhet në mënyrë individuale, në dyshe por dhe grupe të vogla.</p>
<p>REFLEKTIMI</p>	<p>Fushat e integruara: arti, shëndeti fizik dhe zhvillimi lëvizor, gjuha dhe komunikimi, zhvillimi social dhe emocional.</p>

 <p>3-4 VJEÇ</p>	<p>TEMA <b>UNË PO RRITEM - (trupi im)</b></p>
<p><b>NËNFUSHA</b></p>	<p><b>Kreativiteti</b></p>
<p>STANDARDI 3</p>	<p>Fëmija tregon interes për të marrë pjesë në aktivitete të ndryshme vizuale</p>
<p>TREGUESI</p>	<p>Fëmija përdor ngjyrat e ujit dhe i pëzien ato</p>
<p>PLANIFIKIMI I AKTIVITETIT TË TË MËSUARIT</p>	<p><b>Nëntema:</b> Dora ime</p> <p><b>Rezultati i pritur:</b> Ngjyrosin dorën në mënyrë të pavarur</p> <p><b>Materialet dhe mjetet:</b> Fletë A4, ngjyrat e ujit, pastell, letra me ngjyra, hamer</p> <p><b>Organizimi i aktivitetit:</b> Të ndarë në grupe fëmijët ulen rreth tavolinës. U japim udhëzime të qarta për atë që duhet të bëjë secili prej tyre. Por në fillim edukatorja e bën vetë veprimin, ajo vendos dorën e saj në pjatën me ngjyrë dhe pastaj e vendos në fletën A4. Edukatorja sigurohet që të gjithë fëmijët e shohin. Më pas, i ofrojmë ngjyrat e lëngshme në mes të tavolinës në tasa apo pjata, dhe inkurajojmë që secili fëmijë një nga një, e fut dorën në ngjyrën që i pëlqen më shumë dhe e vendos në fletë. Të njëjtën gjë e bëjnë edhe në hamer, ku fëmijët do të vendosin shenjat e dorës së tyre dhe pranë secilës shenjë të dorës, edukatorja do të shkruajë emrin e secilit fëmijë. Punën e përbashkët të fëmijëve në hamer, mund ta vendosim në një vend të dukshëm të përshtatshëm në kopsht. Ndërsa fletët A4 i ruajmë në dosjet e fëmijëve.</p>
<p>REFLEKTIMI</p>	<p>Të gjithë fëmijët morën pjesë në aktivitet, ku ngjyrosën dorën dhe lanë gjurmët e tyre. Përpos N. N. nuk mori pjesë në aktivitet. Fushat e integruara ishin: arti, shëndeti fizik dhe zhvillimi lëvizor, gjuha dhe komunikimi, zhvillimi social dhe emocional.</p>

 <p>4-5 VJEÇ</p>	<p>TEMA <b>STINËT</b> (veprimtaria: dëgjim-krijim)</p>
<p><b>NËNFUSHA</b></p>	<p><b>Kreativiteti</b></p>
<p>STANDARDI 2</p>	<p>Fëmija shfaq interesim për muzikën dhe prire individuale për aktivitete/veprimtari të ndryshme muzikore</p>
<p>TREGUESI</p>	<p>Fëmija krijon lëvizje që marrin formë më përmbajtësore (një lloj vallëzimi sipas ritmit dhe muzikës)</p>
<p>PLANIFIKIMI I AKTIVITETIT TË TË MËSUARIT</p>	<p><b>Nëntema:</b> Dramatizimi i këngës “Moj buburrec”</p> <p><b>Rezultati i pritur:</b> Bëjnë lëvizje në përputhje me ritmin e këngës</p> <p><b>Materialet dhe mjetet:</b> Cd playeri, maskat dhe kostumi i buburrecës, 1-2 topa pingpongu të ngjyrosur</p> <p><b>Organizimi i aktivitetit:</b> Fëmijët e vendosur në formë rrethi dëgjojnë këngën, “Moj buburrece” përmes cd-playerit. Një fëmijë i veshur si buburrec ulet në gjunjë, në qendër të rrethit. Me duar dhe këmbë bën sikur grumbullon barishtet dhe topthat e saj. Fëmijët duke u lëkundur, sa djathtas e majtas i kërkojnë buburrecës grurë që t’ia kthejnë në verë. Në rolin e buburrecës hyjnë fëmijët me radhë ... Ndërkohë që presin t’iu vijë radha për të bërë buburrecin, ata bëjnë lëvizjet që dëshirojnë sipas ritmit të këngës. Edukatorja siguron që të gjithë fëmijët janë të angazhuar në lëvizje, dhe demonstroi disa prej lëvizjeve të buburrecit.</p>
<p>REFLEKTIMI</p>	<p>Fëmijët bëjnë lëvizje të koordinuara, njëkohësisht kanë kuptuar dëshirën për punë dhe ndihmën për shokët. Dy nga fëmijët N &amp; N kanë hezituar të interpretojnë rolin e buburrecit.</p> <p>Fushat e integruara: arti, shëndeti fizik dhe zhvillimi lëvizor, gjuha dhe komunikimi, zhvillimi social dhe emocional, natyra dhe shoqëria, zhvillimi matematikor.</p>

 <p>5-6 VJEÇ</p>	<p>TEMA <b>KAFSHËT</b> (Veprimtaria, interpretim)</p>
<p><b>NËNFUSHA</b></p>	<p><b>KREATIVITETI</b></p>
<p>STANDARDI 1</p>	<p>Fëmija demonstroi aftësi të dallojë tingujt e ndryshëm</p>
<p>TREGUESI</p>	<p>Mund t'i këndojë tekstet që i ka mësuar përmendësh</p>
<p>PLANIFIKIMI I AKTIVITETIT TË TË MËSUARIT</p> <div data-bbox="208 733 495 1202" style="border: 1px solid blue; border-radius: 50%; padding: 10px; width: fit-content; margin: 10px auto;"> <p><i>Zgjidhni atë lojë, aktivitet që ju mundëson fëmijëve të zhvillojnë të paktën 8-10 herë veprimin e pritur.</i></p> </div>	<p><b>Nëntema:</b> Kënga “Kam një mace, kam një qen”</p> <p><b>Rezultati i pritur:</b> Interpretojnë tekstin dhe melodinë</p> <p><b>Materialet dhe mjetet:</b> piano-sinti, instrumentet ritmike (shkopinjë, marakasi etj.).</p> <p><b>Organizimi i aktivitetit:</b> Fillimisht do të bisedojmë për kafshët shtëpiake, duke bërë pyetje: A i doni kafshët shtëpiake? Kush kujdeset për to? Si bën lopa, kali, delja, qeni, macja? Po macën dhe qenin, a i doni? Pikërisht sot do ta mësojmë një këngë që flet për macen dhe qenin. Kënga interpretohet në mënyrë artistike me të gjitha elementet e këndimit të drejtë dhe të bukur. Këngën e këndojmë disa herë (3-4 herë) duke e përcjellur herë pas here me instrument. Kur vërehet se fëmijët janë emocionuar dhe inkuadruar në këndim, qoftë përmes levizjeve, qoftë duke u bashkangjitur në ndonjë pjesë të kenges, do të fillojmë me mësimin e këngës. Për ta lehtësuar mësimin e këngës atë do ta ndajmë në pjesë (frazë) me nga katër takte. Kënga do të mësohet pjesë pjesë duke i lidhur ato dhe duke e përsëritur fëmijët pas edukatores.</p> <p>Në mënyrë që të mos jetë ora monotone për fëmijët do ta dramatizojmë një lojë: në fushë lojë ka aq karrigje të mëdha sa ka fëmijë. Këto do të jenë “vrimat e minjve” në mes të karrigeve, “minjtë” do të vrapojnë këmbaduarsh kur macja mjaullon. Në fund përsërisim këngën duke kërkuar nga fëmijët nëse dikush dëshiron të këndoje në grupe më të vogla, dyshe, ose individualisht.</p>

## REFLEKTIMI

Shumë prej fëmijëve kanë kënduar këngën si tërësi në ritëm, melodi dhe tekst të saktë. Një numër më i vogël (4-5 veta) kanë aritur ta interpretojnë tekstin por jo edhe melodinë e këngës.

Fushat e integruara: **shëndeti fizik dhe zhvillimi lëvizor** standardi 3-fëmija tregon aftësinë të koordinimit të lëvizjeve të tyre, nënfusha 1 – zhvillimi i aftësive lëvizore, **gjuha dhe komunikimi** Standardi 2- fëmija tregon aftësi për të dëgjuar dhe kuptuar gjuhën e folur Nënfusha 1- të dëgjuarit dhe të folurit, **zhvillimi social** standardi 2 Fëmija mund të ndërveprojë me personat përreth, **zhvillimi emocional** standardi 2 Fëmija përjeton, njeh dhe shpreh emocionet. **zhvillimi matematikor** standardi 3- fëmija klasifikon, grupon dhe krahason sende dhe objekte.



## Arti dhe Muzika MODEL PLANIFIKIMI

FUSHA: QASJA NDAJ TË MËSUARIT

MARRË NGA PLANIFIKIMI VJETOR I  
INSTITUCIONIT

I referohemi SZHMFH

<p><b>6 - 18 MUAJ</b></p>	<p><b>TEMA</b> <b>NDËRTOJMË ME DUART TONA</b></p>
<p><b>NËNFUSHA</b></p>	<p><b>Qasja ndaj të mësuarit</b></p>
<p>STANDARDI</p>	<p>Në aktivitetet e përditshme fëmijët përdorin imagjinatën e tyre dhe kreativitetin.</p>
<p>TREGUESI</p>	<p>Fëmija përdor lodrat në mënyra të ndryshme, duke i kombinuar ato në mënyrë kreative.</p>
<p>PLANIFIKIMI I AKTIVITETIT TË TË MESUARIT</p>	<p><b>Nëntema:</b> Krijojmë vetë</p> <p><b>Rezultati i pritur:</b> Fëmijët zgjedhin lodrën që duan për lojën e tyre.</p> <p><b>Materialet dhe mjetet:</b> CD me muzikë, figura të ndryshme të ngjyrosura, kapakë me ngjyra</p> <p><b>Organizimi i aktivitetit:</b> Për aktivitetin e sotëm, bashkë me fëmijët lëvizim nëpër tavolina duke ju treguar posterin që ka secila dhe shportën me kapakët me ngjyra. I ndajmë fëmijët në grupe duke i vendosur që të zgjedhin një kapak dhe fëmijët që kanë kapakët me të njëjtën ngjyrë janë në një grup. Udhëzojmë fëmijët që të krijojnë çfarëdo që ata dëshirojnë duke kombinuar kapakët me figurat. Gjatë punës së tyre, inkurajojmë idetë e fëmijëve, lavdërojmë dhe sigurohemi që të gjithë të jenë të përfshirë në aktivitet. Aktiviteti përmbyllet duke vizituar sërish të gjithë bashkë krijimet e secilës tavolinë.</p>
<p>REFLEKTIMI</p>	<p>-Shumica e fëmijëve kombinuan kapakët me figurat -Aktiviteti u lidh me zhvillimin e shkencës standardi 1- fëmija mbledh informata për ambientin përmes vëzhgimit dhe manipulon me këtë; me zhvillimin emocional, standardi 3- fëmija manifeston aftësi të rregullimit të emocioneve, me zhvillimin social, standardi 2- fëmija mund të ndërveprojë me personat përreth; me gjuhën, standardi 2- fëmija tregon aftësi për të dëgjuar dhe kuptuar gjuhën e folur. -U siguria gjithëpërfshirja e fëmijëve në aktivitet.</p>

Ju mund të përdorni çfarëdo materialesh, që mendoni se e bëjnë aktivitetin interesant për fëmijët.



I REFEROHEMI  
SZHMFH

MODEL  
PLANIFIKIMI

MARRË NGA PLANIFIKIMI  
VJETOR I INSTITUCIONIT

18-24 MUAJ

TEMA  
UNË MUNDEM VETË

NËNFUSHA

Qasja ndaj të mësuarit

STANDARDI

Fëmija tregon aftësi të marrë pjesë në disa aktivitete, veprimtari dhe të këmbëngulë në të edhe kur përballlet me pengesa apo vështirësi.

TREGUESI

Fëmija përpqet vetë të zgjidhë një situatë.

PLANIFIKIMI I  
AKTIVITETIT TË TË  
MËSUARIT

Nëntema: Përshtasim ngjyrat

**Rezultati i pritur:**

Hedhin kapakun nëpër tubin  
me të njëjtën ngjyrë.

Shkruhet në formën e foljes  
vepruese konkrete, të  
matshme, të vëzhgueshme

**Materialet dhe mjetet:** kapakë me ngjyra dhe tuba letre të ngjyrosur, tasa, spango/ pe për thurje

**Organizimi i aktivitetit:**

Bëjmë katër rrrathë me ngjyra në dysheme dhe kërkojmë nga fëmijët të vendosen në secilin prej tyre. I pyesim cilat janë këto ngjyra? Pse zgjodhën një prej tyre? Cila ju pëlqen më shumë? Kush ka më shumë rroba që kanë këto ngjyra? Po pijet që pëlqejnë çfarë ngjyre kanë? Po kapakët e tyre? Më pas ju tregojmë çfarë kemi përgatitur për ta në tavolina dhe ju japim udhëzimet përkatëse: secili nga ju do të merrni një kapak me ngjyrë dhe do ta hidhni nëpër tubin me të njëjtën ngjyrë.

I mbikëqyrim në vazhdimësi duke u siguruar që secili të angazhohet dhe ju japim hapësirë edhe fëmijëve që këmbëngulin derisa ta bëjnë siç duhet. Fëmijët janë të lirë të provojnë disa herë.



Zgjidhni atë  
lojë, aktivitet  
që ju  
mundëson  
fëmijëve të  
zhvillojnë të  
paktën 6-8  
herë  
veprimin e ri.




## REFLEKTIMI

Më pak se gjysma e fëmijëve arritën të hedhin kapakun nëpër tub.  
Aktiviteti u ndërlidh me zhvillimin motor fine –standardi 2-fëmijët tregojnë aftësi të koordinimit sy-dorë; me zhvillimin emocional, standardi 3-fëmija manifeston aftësi të rregullimit të emocioneve; me zhvillimin matematikor, standardi 3-fëmijët klasifikojnë, grupojnë dhe krahasojnë objekte.  
Të gjithë fëmijët morën pjesë në aktivitet.


### ***Jepuni përgjigje këtyre pyetjeve:***

1. Sa fëmijë e realizuan rezultatin e pritur?
2. Me cilat fusha u integrua aktiviteti?
3. Sa u siguria gjithëpërfshirja e fëmijëve?

<p style="text-align: center;"><b>2-3 VJEÇ</b></p>	<p><b>TEMA</b> <b>NDRYSHIMET KLIMATIKE</b></p>
<p><b>NËNFUSHA</b></p>	<p><b>Qasja ndaj të mësuarit</b></p>
<p>STANDARDI</p>	<p>Fëmija demonstroi aftësinë për të mësuar në mënyra të ndryshme përmes eksperiencave të tij/saj.</p>
<p>TREGUESI</p>	<p>Fëmija flet dhe u tregon të tjerëve se çfarë i ka ndodhur në të shkuarën.</p>
<p>PLANIFIKIMI I AKTIVITETIT TË TË MËSUARIT</p> <div style="border: 1px solid black; padding: 5px; margin-top: 10px;"> <p style="text-align: center;"><i>Jini të lirë të përcaktoni cili është opsioni më i mirë për ju!</i></p> <p style="text-align: center;"><b>OSE</b></p> <p style="text-align: center;"><i>Vendosni ju si do ta filloni aktivitetin!</i></p> </div>	<p><b>Nëntema:</b> Lulet</p> <p><b>Rezultati i pritur:</b> Flasin rreth luleve</p> <p><b>Materialet dhe mjetet:</b> Pamje të luleve në stinë të ndryshme</p> <p><b>Organizimi i aktivitetit:</b></p> <p><b>Opsioni 1:</b> Vendosim një këngë për lulet në sfond dhe bashkë me fëmijët kërcëjmë sipas muzikës</p> <p><b>Opsioni 2:</b> vendosim një CD në të cilën tregohen pamje të fushave me lule në stinë të ndryshme</p> <p><b>Opsioni 3:</b> Përgatitim posterë të vegjël ku kemi vizatuar ne ose fëmijët në aktivitetet e tjera, lule në stinë të ndryshme dhe i vendosim nëpër mure</p> <p>Pasi kemi kryer një aktivitet të vogël hyrës (sipas opsioneve) pyesim fëmijët pse ju pëlqejnë lulet? Ku kanë parë më shumë lule? A kanë mbjellë ndonjëherë lule me duart e tyre? A kujdesen për to? A i ujisin? Sipas përgjigjeve stimulojmë të treguarit e tyre për eksperiencat personale dhe përpiqemi të bëjmë lidhjen e lulëzimit të luleve me ndryshimet e kohës. Stimulojmë të gjithë fëmijët të tregojnë diçka, duke ruajtur kujdesshëm balancin e sasisë së tregimeve. Nxitim fëmijët më të heshtur që të tregojnë një eksperiencë të tyre.</p>
<p>REFLEKTIMI</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Shumica e fëmijëve treguan shumë pak për eksperiencat e tyre</li> <li>- Vetëm katër fëmijë treguan më gjerë për lulet dhe ndryshimet</li> <li>- Aktiviteti u ndërlidh me zhvillimin gjuhësor, standardi 2 – fëmija tregoi aftësi për të dëgjuar dhe kuptuar gjuhën e folur; me zhvillimin emocional-standardi 2-fëmija përjeton, njeh dhe shpreh emocionet; me shkencën, standardi 3 –fëmija vëzhgon dhe përshkruan karakteristikat e botës jo të gjallë, me qasjen ndaj të mësuarit, standardi 1 - fëmija shpreh interes dhe kuriozitet për të mësuar gjërat e reja.</li> <li>- Vajzat u treguan më të shkathta dhe më të gatshme se djemtë.</li> </ul>

 <p>3-4 VJEÇ</p>	<p>TEMË JAVORE <b>NË BOTËN E PËRRALLAVE</b></p>
<p><b>NËNFUSHA</b></p>	<p><b>Qasja ndaj të mësuarit</b></p>
<p>STANDARDI</p>	<p>Fëmija shpreh interes dhe kuriozitet për të mësuar për gjërat e reja</p>
<p>TREGUESI</p>	<p>Në mënyrë të pavarur zgjedh lodrat që i duhen për lojën e tij/saj</p>
<p>PLANIFIKIMI I AKTIVITETIT TË TË MËSUARIT</p> <div data-bbox="182 616 420 854" style="border: 2px solid blue; padding: 5px; margin-top: 20px;"> <p><i>Lidhni aktivitetet e të nxënit me ato të një dite më parë!</i></p> </div>	<p><b>Nëntema:</b> Dramatizim – përralla .....</p> <p><b>Rezultati i pritur:</b> Zgjedh personazhin e parapëlqyer për dramatizim</p> <p><b>Materialët dhe mjetet:</b> Disa personazhe të vizatuara ose prej materiali, një miniskenë e improvizuar në sallë</p> <p><b>Organizimi i aktivitetit:</b> Kujtojmë bashkë me fëmijët cilën përrallë e kemi lexuar dje, ose cilin personazh kemi gjetur dje kur bashkuam copëzat. Bisedojmë bashkë me fëmijët rreth tyre dhe kërkojmë nga ata që të vendosin se cili prej personazheve dëshirojnë ata që të jenë? I lejojmë që të zgjedhin figurën, personazhin e dëshiruar. Më pas japim udhëzime për dramatizimin e përrallës. Fëmijët do të ndjekin me kujdes leximin e edukatores dhe do të bëjnë atë që pritet prej personazhit që janë. Mos shqetësoni edhe nëse dy ose tre fëmijë zgjedhin të njëjtin personazh...lejojini të jenë kreativë në atë që do të bëjnë ose thonë. Sigurojmë që të gjithë fëmijët të jenë pjesëmarrës aktivë në dramatizim, qoftë si personazhe kryesore apo si dëgjues aktivë.</p>
<p>REFLEKTIMI</p>	<p>Të gjithë fëmijët zgjedhën nga një personazh të preferuar Aktiviteti u ndërlidh me fushën e gjuhës, standardi 2-fëmija tregon aftësinë për të dëgjuar dhe kuptuar gjuhën e folur; me zhvillimin emocional, standardi 2-fëmija përjeton një dhe shpreh emocionet; me zhvillimin social, standardi 2-fëmija mund të ndërveprojë me persona përreth; me zhvillimin e të dëgjuarit dhe të folurit, standardi 4 – fëmija shpreh aftësi kreative gjuhësore. Edhe vajzave edhe djemve ju dha mundësi për të luajtur personazhin e tyre.</p>

 <p>4-5 VJEÇ</p>	<p>TEMA <b>NDËRTOJMË ME DUART TONA</b></p>
<p><b>NËNFUSHA</b></p>	<p><b>Qasja ndaj të mësuarit</b></p>
<p>STANDARDI</p>	<p>Fëmijët janë të aftë të marrin iniciativë në veprimtarinë e tyre</p>
<p>TREGUESI</p>	<p>Fëmija i kërkon shokut-shoqes të luajë me të.</p>
<p>PLANIFIKIMI I AKTIVITETIT TË TË MËSUARIT</p> 	<p><b>Nëntema:</b> Kopshti im me lule</p> <p><b>Rezultati i pritur:</b> Krijojnë kopshtin e tyre me lule</p> <p><b>Materialet dhe mjetet:</b> Lule plastike, bimë të gjalla nga oborri, gjethe, disa copa stiropori [bukpeshku], ujitëse lulësh</p> <p><b>Organizimi i aktivitetit:</b>  <b>Opsioni 1:</b> Nxjerrim fëmijët në kopsht dhe kërkojmë që të shohin me kujdes rregullimin e tij  <b>Opsioni 2:</b> Imbledhin fëmijët rreth dritareve dhe bashkë me ta shohim oborrin e rregulluar dhe lulet në të  <b>Opsioni 3:</b> Bisedojmë me fëmijët rreth oborrit të tyre dhe kërkojmë të dijnë sa kontribuojnë ata në mbajtjen e tij. I ndajmë në grupe në këtë mënyrë: kërkojmë 5 vullnetarë dhe secili prej tyre do të zgjedhë shokët/shoqet e grupit të tij/saj, njëri pas tjetrit. Edukatoja është e kujdesshme që të zgjedhë edhe vajza edhe djem. Ju tregojmë materialet që kemi përgatitur për ta dhe i udhëzojmë që të ndërtojnë/krijojnë një oborr me lule sipas dëshirës së tyre. Pasi jemi siguruar që secili fëmijë është pjesë e një grupi, i drejtojmë për në tavolina dhe i stimulojmë që të punojnë së bashku në ndërtimin e kopshtit të tyre. I mbikëqyrim në vazhdimësi, duke u siguruar që secili të angazhohet. I udhëzojmë që nëse kanë nevojë për ndihmë t'i drejtohen shokut/shoqes e më pas edhe edukatores. Kopshtet e përfunduara, të vendosura në secilën tavolinë, i shikojnë të gjithë fëmijët e grupeve.</p> 
<p>REFLEKTIMI</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Shumica e fëmijëve morën pjesë në ndërtimin e kopshtit të tyre</li> <li>- Aktiviteti u ndërlidh me shkencën, standardi 2 - fëmija vëzhgon dhe përshkruan botën e gjallë; me zhvillimin social, standardi 2 - fëmija ndërvepron me personat përreth; me zhvillimin emocional, standardi 3-fëmija mund të manifestojë aftësi të vetërregullimit të emocioneve; me zhvillimin e aftësive lëvizore fine, standardi 1-fëmijët tregojnë aftësi të përdorimit të duarve dhe gishtave</li> <li>- Të gjithë fëmijët morën pjesë në aktivitet.</li> </ul>

 <p>5-6 VJEÇ</p>	<p>TEMË MUJORE <b>TË GJITHË TË NDRYSHËM, TË GJITHË TË BARABARTË</b></p>
<p><b>NËNFUSHA</b></p>	<p><b>Qasja ndaj të mësuarit</b></p>
<p>STANDARDI</p>	<p>Në aktivitetet e përditshme fëmijët përdorin imagjinatën e tyre dhe kreativitetin</p>
<p>TREGUESI</p>	<p>Fëmija ndryshon tregimet e njohura duke prezantuar personazhe të krijuara prej tij/saj, duke ndryshuar edhe rrjedhën e tregimit.</p>
<p>PLANIFIKIMI I AKTIVITETIT TË TË MËSUARIT</p>	<p><b>Nëntema:</b> Unë jam ndryshe</p> <p><b>Rezultati i pritur:</b> Fëmijët vazhdojnë prezantimin e vetes sipas dëshirës</p> <p><b>Materialet dhe mjetet:</b> Foto të fëmijëve të ndryshëm</p> <p><b>Organizimi i aktivitetit:</b> Bisedojmë me fëmijët në rreth duke i pyetur për karakteristikat e fëmijëve të ndryshëm që panë në foto dhe të njerëzve që ata njohin. Ju japim mundësi të gjithëve që të marrin pjesë në diskutim dhe të shprehin mendimin e tyre. Më pas ju tregojmë që sot do të prezantojmë veten secili prej nesh, duke përmendur çka na dallon nga të tjerët dhe çka kemi të përbashkët me të tjerët. E fillojmë sipas dëshirës së fëmijëve dhe inkurajojmë që ata të identifikojnë veçoritë e fëmijëve të prezantuar në fillim të aktivitetit. Më pas presim që ata të plotësojnë ato veçori që kanë specifike dhe çka mund të bëjnë me ato veçori. Secili fëmijë tregon për veten dhe edukatorja kujdeset që të vendosë theksin në mundësitë e barabarta që ka secili fëmijë, pavarësisht dallimeve që kanë me njëri-tjetrin.</p>
<p>REFLEKTIMI</p>	<p>Shumica e fëmijëve treguan për veçoritë e tyre x, y, z treguan shumë pak dhe nuk ditën të lidhin veçoritë me mundësitë Aktiviteti është ndërlidhur me zhvillimin e të dëgjuarit dhe të folurit, standardi 2 dhe 3 -fëmija tregon aftësi për të dëgjuar dhe kuptuar gjuhën e folur, dhe për të komunikuar; me zhvillimin social, standardi 1-fëmija mund të bëjë dallimin me persona të njohur dhe të panjohur; me zhvillimin emocional, standardi 1-fëmija demonstroi se njeh konceptin për veten. Në aktivitet u siguroi gjithëpërfshirja e fëmijëve.</p>

## Literatura

- MASHT (2011) *Standardet e Zhvillimit dhe të Mësuarit në Fëmijërinë e Hershme 0-6 vjeç*
- MASHT (2012) *Modulet për zbatimin e dokumentit të Standardeve të Zhvillimit dhe të Mësuarit në Fëmijërinë e Hershme*
- MASHT (2006) *Kurrikula e Edukimit Parashkollor mosha 3-6 vjeç*
- *Modele planifikimi të institucioneve parashkollore, Prishtinë, 2014*

### ***Udhëzuesi praktik për zbatimin e dokumentit të Standardeve të Zhvillimit dhe të Mësuarit në Fëmijërinë e Hershme***

---

Ky Udhëzues është mbështetur nga:



**Balkan Sunflowers**  
Volunteers for Social Reconstruction

